



NË PRITJE TË SHPËRBLIMIT

Jeta e çdonjërit prej nesh është në shpenzim të vazhdueshëm. Koha ecën dhe nuk ndalet, as kur rrimë, as kur lëvizim. Pjesë e gjithë kësaj është edhe muaji i bekuar i Ramazanit, prej të cilit u përshëndetëm disa ditë më parë. Njerëzit e mirë kohën pas Ramazanit deri në Ramazanin tjetër e ndanin në dysh, në gjysmën e saj e lusnin Allahun t'ua pranojë aktivitetet e Ramazanit që kaloi, ndërsa në pjesën tjetër të vitit e lusnin që t'ua mundësojë që ta presin tjetrin.

Është interesant se ky muaj kaloi për të gjithë njësoj, si për ata që e agjëruan, e gjallëruan me namaz e aktivitete, si për ata që e privuan veten përgjithmonë nga mirësitë e këtij muaji. Madje, jo vetëm që kaloi, por ata që nuk u lodhën në këtë muaj me asgjë dhe e kanë kaluar më mirë janë agjëruarit dhe falësit. Ata kurrë nuk kanë qenë më të ngopur, as më të pushuar, e as më të kënaqur. Kënaqësia është madje emëruesi, që i ka përcjellë prorre ata më të zellshmit në Ramazan e vetëm ata ia ditën vlerën Ramazanit, e patën mundësinë që ta shijojnë me të vërtetë këtë muaj.

Dalëngadalë erdhi dita e gëzimit, dita e Bajramit, atë ditë në të cilën muslimanët e uruan gjithandej njëri-tjetrin, duke u lutur që të jenë të pranuar, të falur dhe fitimtarë. Gëzimi i kësaj dite vërehet tek çdonjëri. Aktivistët gëzohen, sepse i kanë kurorëzuar me sukses të gjitha aktivitetet dhe adhurimet gjatë muajit të mëshirës. Një dozë gëzimi e kanë edhe ata që ndoshta nuk kanë qenë të zellshëm sa duhet, por e dinë se kanë të bëjnë me Zotin, që është shumë Mëshirues dhe që për pak punë të bërë shpërblen shumë.

Nëse ndonjërit sot i vjen keq, që nuk e ka agjëruar Ramazanin, le ta shfrytëzojë keqardhjen dhe brejtjen e ndërgjegjes, si derë për t'iu afruar Allahut me lutje që në të ardhmen të mos e privojë lutësin nga mundësia për të agjëruar, për t'u falur, për të dhënë sadaka etj...

Vërtetë është shumë mirë kur të vjen keq.

në emër të redaksisë
Ekrem Avdiu

AKTUALE

Klanizimi **3-4**

Ballkani “fuçi baruti” dhe realiteti i ri i

Ballkanit perëndimor **5-6**

BFI nuk e kalon prapun dot **7-8**

KËNDI IM

Të ngelim në Ramazan edhe pas

Ramazanit **9-11**

Filozofia islame nuk ekziston **11-15**

Kultura moderne e ofendimit **16-19**

Ti je pengesë për fitoren e

muslimanëve **20-21**

AKIDE

Sqarimi i shirkut nga dijetarët e

mëdhenj hanefij **22-24**

FIKH

“O të rinj, martohuni” **25-29**

AVANCIMI PERSONAL

Aftësia (mjeshtëria, zotësia) **30-32**

FAMILJA

Detyrimet e gruas ndaj burrit **33-35**

Pesë veçori për ta shtuar bukurinë

e vërtetë **36-39**

Si të jesh bamirës ndaj prindërve... **40-41**

TEFSIR

Komenti dhe vlera e Ajetul Kursisë **42-45**

HADITH

Agjërimi i ditëve të shevalit **46-48**

LIBRI

Prezantim i librit “Furnizimi

për ahiret” **49-50**

BOTA ISLAME

Azerbaixhan **51**

FETVA DHE KONSULTIME

Rregulla dhe dispozita rreth

gjashtë ditëve të muajit Sheval **52-55**

HISTORI

Historia e Palestinës së vjetër dhe

banorët e saj **56-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor

Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI,
Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,
Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: Albislam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: revista@albislam.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

Xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.albislam.com

KLANIZIMI



Fakti që në historinë e shqiptarëve nuk ndeshim ndonjë traditë të qëndrueshme të ekzistencës së shtetit, mbretërive, por përkundrazi të principatave, vilajeteve, bajrakëve dhe çifligjeve, tregon për ekzistencën e fortë të klanit

SHKRUAN: JUSTINIAN TOPULLI

Tipari i klanizimit të shoqërisë shqiptare është një dukuri e vjetër dhe e trashëguar prej shekujsh, aq sa mendon se ai u rrjedh këtyre njerëzve nëpër damarë si gjaku! Ndoshta shqiptari e ka të vështirë të jetojë pa të?!

Janë një sërë faktorësh historikë, kulturorë dhe gjeografikë, që e kanë favorizuar mbijetesën e kësaj forme, shpesh herë negative për ne shqiptarët. Terreni i thyer dhe malor mbi të cilin shtrihet atdheu ynë i ka kushtëzuar deri diku shqiptarët të jetojnë veçmas dhe për rrjedhim t'i japin jetë formës klanore, ky kushtëzim vjen dhe bëhet edhe më i fortë kur kujton faktin që për t'u mbijetuar armiqësive të jashtme dhe gjakmarrjeve të brendshme shqiptarët jetonin të veçuar dhe larg e në vende sa më të mbrojtura. Fakti që në historinë e shqiptarëve

nuk ndeshim ndonjë traditë të qëndrueshme të ekzistencës së shtetit, mbretërive, por përkundrazi të principatave, vilajeteve, bajrakëve dhe çifligjeve, tregon për ekzistencën e fortë të klanit, i cili e vështirësonte krijimin dhe konsolidimin e një shteti parimesh dhe ligjesh.

Një tjetër faktor, që ka ndikuar në ruajtjen e mentalitetit klanor edhe mbas gati një shekulli të lindjes së një shteti të pavarur shqiptar, është dominimi i jetës fshatare karshi asaj qytetare. Pavarësisht shtimit të qyteteve në vendin tonë, ku të paktë ishin ata qytete që mund të thuhej se kishin tiparet e një qyteti të vërtetë, jeta dhe mendësia fshatare ishin mbizotëruese në pjesën më të madhe të vendit. Regjimi komunist që propagandonte se fshatin do ta bënte si qyteti, në fakt, në shumë raste bëri të kundërtën. Sjellja në qytet dhe ngritja në poste drejtuese e shumë fshatarëve të bindur dhe shërbëtorë të regjimit, pa marrë parasysh

shkollimin apo ngritjen intelektuale dhe profesionale të tyre, nuk bëri gjë tjetër vetëm se e fshatarizoi një pjesë të qytetit pa e qytetarizuar fshatarin pushtetar, që tashmë me vendim nga lart ishte bërë udhërrëfyes i qytetarit! Bashkë me këtë fshatarizim të qytetit u ruajt dhe u thellua fryma klanore, pikërisht edhe atje ku në fakt nuk duhet të ekzistojë fryma e klanit: në institucione dhe instanca drejtuese.

Që të jetoje mirë dhe të ngriheshe lart në shoqërinë shqiptare duhet të kishe miq dhe të njohur, që të siguroje shkollë dhe punësim të rehatshëm, nuk ishte e rëndësishme të rridhje nga ndonjë familje e fisme, sesa të vije nga një ambient me baza të forta miqësish, nuk kishte rëndësi nëse ishte nxënës i dhjetës apo profesionist i përkushtuar, mjafton të kishe disa baballarë, xhaxhallarë e dajallarë të fortë dhe ti do të ishte dikush...

Të lindësh dhe të jetosh në fshat nuk është krim dhe as një "caktim fatkeq i Zotit", por të mbartësh mendësi klanore dhe t'i bësh punët fshatçe është e papranueshme edhe nëse ke lindur dhe je rritur në qytet.

Klanizimi është mendësia ku përkulen parimet, ngjyrosen ligjet dhe deformohet morali, ku kredibiliteti rritet nëpërmjet miqësive dhe shoqërimit me të fortët, ku vlerësohesh sesa i shkathët je për të komunikuar dhe lidhur me krerët, paçka se mund të kesh edhe dy klasë shkollë. Klani funksionon me emra ndërsa parimet jo, klani vendos se kë do të vëmë dhe kë do të heqim, ndërsa parimet thonë se më shumë se emrat ka rëndësi morali, klani tenton të hyjë edhe nga penxheret dhe oxhaku, kur nuk hyn dot nga dera, e ndërsa parimi kërkon të hyjë vetëm nga dyert për këdo që e meriton, klani është përjashtues dhe e shikon çdo njeri jashtë tij si kundërshtar ndërsa parimi jo, klani punon me aleanca klanore, ndërsa parimi përplaset ballë për ballë, për klanin ka rëndësi sa njeh dhe sa mund t'ua hedhësh, të

tjerat janë ëndrra. Klani vuan nga kompleksitetet e etiketimeve të pjesëmarrjes dhe shoqërimit me individët jashtë klanorë, klani ndikohet nga thashethemet, hamendjet dhe nuk beson në naivitete dhe sinqeritet... Klani sheh tek anëtarët e tij vetëm anët pozitive, ndërsa tek ata jashtë tij më së shumti vetëm anët negative. Klani nuk është për bashkëpunime të hapura me këdo, nëse frikësohet se uji shkon në mulli të tjetërkujt... klani më së shumti vepron nën hije dhe nuk rrezikon të dalë në dritë... klani nuk pranon të diskutojë, të rrahë mendimet e të përplaslet me alternativa, me argumente dhe kundërgjegje, po i pëlqen më tepër guaska e vet...

Klani del fitimtar ndërsa idealistët parimorë humbasin...!

Klani është gjithmonë një mburojë e preferuar, por që edhe të mban peng të dobësive të tua, ndërsa "budallenjtë idealistë" ngelen me ballin lart, por me barkun thatë ama...! Kjo është Shqipëria, ku elitë bëhet ai që e ka klanin më të fortë dhe ka më shumë ushtarë...! Në shoqërinë shqiptare edhe ata që duan të punojnë për mirë dhe për parime janë të detyruar me hir ose me pahir të punojnë fshatçe, të krijojnë dhe ngrenë klane, sepse ndryshe nga të gjithë do të cilësoheshin si jorealiste dhe idealiste. Që kjo është e vërtetë s'ka pikë dyshimi, por edhe të kërkosht të vendosësh të mirën me metoda klanore je i dënuar të akuzohesh si joparimor, si njeri që bën kompromis me të keqen, paçka se ti synon ta luftosh atë...!

KLANI dhe gjithë pasojat e këqija që ai mbart është një arsye e madhe e përçarjes tonë...

"... e mos u bëni si ata, që i bëjnë Atij ortak tjetër (në adhurim), si ata, që fenë e tyre e kanë përçarë dhe janë ndarë në klane, e ku çdo klan është i kënaqur me atë që ka."
(Rum: 31-32) ■

BALLKANI “FUÇI BARUTI” DHE REALITETI I RI I BALLKANIT PERËNDIMOR

Politika e vjetër ruse e “fuçisë baruti”, nuk është gjë tjetër veçse të mbjelli huti e të sjelli përçarje. Ligjërimi politik nacionalist tashmë ka ndryshuar në një realitet të ri të orientuar nga Perëndimi dhe globalizimi.

SHKRUAN: ROALD A. HYSA

Termi Ballkan i përdorur nga gjeografët nga fundi i shek. XIX shumë shpejt në përdorim mori formë përkeqësuese. Politika ndërkombëtare e Fuqive të Mëdha të kohës e përdori këtë term gjeografik për të treguar një rajon me probleme nacionale dhe vetë ky term u përdor nga politikanët e vendeve ballkanase dhe në ligjërimin e tyre nacionalist tashmë në formën e tij të përkeqësuar. Është e mirënjohur për të gjithë fraza **“Ballkani fuçi baruti”**, por nga të dhënat historike tashmë del se nuk ishte Ballkani me nacionalizmat e veta primitive “një fuçi baruti”, por ishin vetë Fuqitë e Mëdha ndër to kryesisht edhe Rusia, që do ta përdorte Ballkanin dhe kombe të veçanta në Ballkan si “fuçi baruti” gati në plasje për të bërë presion. Kështu Rusia bëri presion ndërkombëtar sa mundi që Kosova të mos e arrinte pavarësinë e saj, duke vazhduar me pragmatizëm politikën e saj në Ballkan dhe duke përdorur edhe shtete të veçanta si mjete presioni. Tashmë ajo çka na habit është deklarata e ambasadorit rus në Tiranë përpara gazetarëve, duke e cilësuar rastin e Kosovës si unik dhe të veçantë pa ia kërkuar



njeri këtë deklaratë. Në pamje të parë duket sikur ka ndonjë mospërputhje ndërmjet qendrës dhe degës së saj të Tiranës, por po të shihet hollë-hollë deklaratat e ambasadorit rus i vijnë për shtat tashmë politikës ruse, e cila do të mbjelli huti, që në një farë mënyre të gjejë e më pas të marrë mbështetje qoftë edhe prej shqiptarëve për njohjen formale ndërkombëtare të Abkhazisë dhe të Osetisë.

Një nga presionet e vazhdueshme në këtë drejtim, pra, përpara se të fillonte konflikti gjeorgjian i diplomacisë ruse ka qenë edhe ky përdorimi i rastit të pavarësisë së Kosovës si një precedent ndërkombëtar. Kështu, tashmë diplomacia ruse po kërkon ta shfrytëzojë maksimalisht shpalljen pavarësisë së Kosovës si precedent ndërkombëtar, por ndërkaq edhe për të tërhequr vëmendjen nga problemi i vërtetë, ai i konfliktit ushtarak dhe ndërhyrjes me forcë në Gjeorgji për ta riorientuar këtë vend drejt politikës satelite të Moskës dhe po përdorin kështu politikën e shashkave tymuese në Ballkan. Kjo lloj politike rezulton të jetë e dështuar kundrejt Tiranës dhe shumë prej vendeve ballkanike për shkak të orientimeve diplomatike drejt Perëndimit dhe organizmave kryesore të tij, Bashkimit Evropian dhe NATO-s.

Përfshirja e vendeve të Ballkanit Perëndimor në proceset integruuese evropiane tashmë ka shërbyer si një politikë preventivuese ndaj këtyre problemeve që Moska kërkon t'i rihapë në Ballkan me politikën e saj pragmatike e të vjetra, të cilat nuk mund ta rikthejnë Ballkanin, apo më mirë të themi Ballkanin Perëndimor në një "fuçi baruti". Pas mandatimit 2 herësh si president i Rusisë, Putini tashmë kryeministër i saj e ndjen veten të fortë për t'iu rikthyer lojës së "të fortëve", pikërisht të asaj loje, të cilën e udhëhoqën paraardhësit e tij, atë të Luftës së Ftohtë.

“Rusët e kanë ndjerë këtë gjë prej kohësh, por me sa duket tashti e ndjenë veten të fuqishëm për të çelur një luftë, e cila është një përpjekje e fuqishme për të thyer kordonin sanitar perëndimor...”

Ishte pikërisht kjo Luftë, e cila do ta nxirrte humbëse Rusinë dhe do ta nxiste Perëndimin dhe SHBA-të të merrnin masat e tyre parandaluese për ta kufizuar Rusinë dhe për t'ia hequr zonat e saj të influencës. Proceset integruuese të vendeve të bllokut lindor në NATO dhe BE i shërbyen Perëndimit që të krijojnë një farë kordoni sanitar, ku në këto vende u futën edhe Gjeorgjia e ndonjë vend tjetër tradicionalisht nën ndikimin e fuqishëm të Rusisë. Rusët e kanë ndjerë këtë gjë prej kohësh, por me sa duket tashti e ndjenë veten të fuqishëm për të çelur një luftë, e cila është një përpjekje e fuqishme për të thyer kordonin sanitar perëndimor. Përpjekjet diplomatike nuk është se dhanë frytet e duhura me gjithë justifikimet ruse për të krijuar një rrjet marrëveshjesh diplomatike mbrojtëse me efekte edhe të karakterit ushtarak, siç që marrëveshja e vendeve të Detit Kaspik, ku në të u përfshi edhe Irani, përveç ish-republikave sovjetike. Nafta ruse për të cilën Evropa ka aq shumë nevojë rezultoi si një mjet i dobët presioni dhe në ditët në vijim do të shohim se si do të mbyllet konflikti gjeorgjian. ■

BFI NUK E KALON PRAGUN DOT

Për t'u kapërcyer ky prag dhe për ta kaluar fazën e tranzicionit, këtij institucioni nuk i ka mbetur për fat të keq përveç dy opsioneve, ku dallimi ndërmjet njërit dhe tjetrit është mu si dita me natën, ose qielli me tokën

SHKRUAN: SEDAT SHABANI

Edhe ky Ramazan i gjeti muslimanët e Maqedonisë dhe institucionin e vetëm të tyre në gaflet. Kaluan edhe këto zgjedhje dhe pjesë e qeverisë u bë partia, e cila pati një konflikt direkt me këtë institucion ose me vetë kreun e saj, duke shkëmbyer akuza dhe deklarata të ndryshme ku BDI-ja akuzonte BFI-në për servilizëm ndaj njëres parti, e institucioni kthente përgjigjen se gjoja PDSH-ja paska qenë e vetmja që qenka kujdesur për të mirën e saj. Por falë Zotit, ditëve të Ramazanit shpërtheu e keqja edhe në atë subjekt politik siç edhe pritej, pasi *“zullumi këputet kur të trashet”* thotë populli.

Si shkojnë ditët e Ramazanit shtohet pesimizmi dhe humbet shpresa se ka mundësi të ndërrohet diçka në BFI, ajo që i ndodhi ditëve të Ramazanit patronëve te dikurshëm te BFI-së nuk ka mundësi t'i ndodhë edhe vetë BFI-së, sepse BFI-ja ka zhdukur çdo qelizë që ka në të, duke ngulfatur kështu pa masë e kandar çdo iniciativë brenda saj, sikurse



pamë serialin e fundit **“myftiu i Shkupit kundër Reisit”**.

Pesimizmi shtohet edhe më, kur kihet parasysh se partia shqiptare në pushtet nuk ka mundësi të bëjë, as keq e as mire për këtë institucion, ata me sa duket në këtë rast janë **“as hairi i turkut e as sherri i kaurit”**, jo se nuk dëshirojnë ose nuk kanë vullnet, por thjesht nuk kanë ide e as aftësi të ndikojnë në përmirësimin e saj. Falë Zotit nuk janë si paraardhësit e tyre, të cilët me nijet nuk e përmirësonin këtë institucion pasi kishin leverdi bandash, por shkuan deri aty sa edhe e kthyen procesin dekada mbrapa. Ajo që bënë ata është sikur në Kosovë të kthesh në skenë politike Rahman Morinën ose Fadil Hoxhën, apo në Bashkësinë Islame të Bosnjës Haxhiabdiçin e në Kosovë Jetishin?!...

Kjo për fat të keq ka ndodhur vetëm në Maqedoni dhe është fenomen, i cili kërkon shqyrtime të veçanta.

Çdo bashkësi islame, simotra të kësaj sonës në ish-republikat e dikurshme të Jugosllavisë, sikurse Bosnja, Mali i Zi, Kosova po edhe Serbia e kanë kaluar fazën e

tranzicionit në mënyrë të natyrshme dhe pa turbulenca të zëshme apo tronditje. Ato sot funksionojnë në të mirë të besimtarëve të vet, imamët dhe nëpunësit e tyre paguhen shumë më mirë se tanët, edhe pse zotërojnë shumë më pak mundësi financiare sesa ne... madje ndihmojnë edhe shtetin e tyre në arritjen e përparimeve të kërkuara në integrimet e parapara, ku ndërtojnë me sukses institucionet e veta, begatojnë jetën fetare dhe e institucionalizojnë atë, e me këtë shtojnë bereqetin, duke prodhuar harmoni për shoqëritë e tyre. Ndërsa te ne, lëre që nuk u kalua pragu, këtu kam parasysh në dështimin e një brezi të tërë, mendoj për gjeneratën e profesorëve të mi Bahri ef. Aliu, hfz. Ismail Bardhit, Muhamed ef. Aruçit e pse jo edhe Sabahudin ef. Mahmuti, por rrota u kthye mbrapa pa fije turpi, tamam si në filmat e vampirëve.

Për t'u kapërcyer ky prag dhe për ta kaluar fazën e tranzicionit, këtij institucioni nuk i ka mbetur për fat të keq përveç dy opsioneve, ku dallimi ndërmjet njërit dhe tjetrit është mu si dita me natën, ose qielli me tokën:

I Pari: pas të gjitha këtyre peripecive, zënkave e kacafytjeve në çdo ndërrim qeverish apo zgjedhjesh parlamentare, ky institucion ka nevojë për konsensus në vetveten e tij, por më me rendësi është marrëveshja dhe vullneti i mirë ndërmjet faktorit politik dhe organizatave joqeveritare që kontribuojnë në afirmimin e vlerave fetare. Po pati mundësi që në këtë proces të futen edhe partitë e turqve, boshnjakëve, torbeshëve dhe romëve dhe të gjithë së bashku ta ndiejnë këtë institucion si të vetin do të ishte shumë më mirë. Mjaft më u zhvlerësua BFI-ja derisa erdhi në atë masë, sa që u bë leckë në duart e mendjelehtëve dhe njerëzve të papërgjegjshëm. Në këtë mënyrë unë mendoj se ajo do të stabilizohet pa dhembje dhe turbulenca njëherë e përgjithmonë, anija e vetme e muslimanëve

“Mjaft më u zhvlerësua BFI-ja derisa erdhi në atë masë, sa që u bë leckë në duart e mendjelehtëve dhe njerëzve të papërgjegjshëm...”

të këtushëm, e me këtë do të marrë fund spiralja e së keqes, e cila përsëritet me ndërrimin e qeverive dhe partive në pushtet.

Ky option është më i miri dhe më i shëndoshi.

I Dyti: është option zori, të bëhet regjistrimi i një subjekti të ri, i cili do të artikulojë kërkesat dhe interesat e muslimanëve të Maqedonisë, ku do të merrnin pjesë teologët, të cilët nuk pajtohen me politikën totalitare të kreut të BFI-së, si dhe nuk e gjejnë veten aty, me që dyert u janë mbyllur dhe që mendojnë të punojnë me ndërgjegje të pastër, gjë për të cilën edhe janë shkolluar në universitete të ndryshme, që të japin gjithashtu edhe kontributin e tyre për shoqërinë. Njëkohësisht do të luanin kështu rolin e opozitës dhe me konstruktivitetin e tyre do ta detyrojnë BFI-në që t'i hapë dyert e saj dhe një ditë prej ditëve të bashkohen nën një emër dhe për të mirën e të gjithëve. Këtë iniciativë duhet ta mbështesë edhe faktori politik, së bashku me atë të Bashkësisë Ndërkombëtare.

Kështu do të shmangeshin tensionet e panevojshme edhe për vetë shtetin në këto çaste të ndjeshme.

Besoj se deri tek opsioni i dytë nuk do të vijë puna dhe e lus Allahun në këto ditë të bekuara të Ramazanit t'i zbutë zemrat e besimtarëve, të largojë zilinë nga ata, t'i begatojë me dashuri dhe rahmet për njeri-tjetrin e posaçërisht thirrësat e tyre, hoxhallarët.

Amin.



TË NGELIM NË RAMAZAN EDHE PAS RAMAZANIT

Pas ndarjes me Ramazanin zemrat tona mbushen me frikë, turp, keqardhje dhe pikëllim, sepse nuk e dimë sa ishim të singertë në të. Sa u përmbushën pretendimet që shprehëm duke thënë se do ta bëj këtë... do ta bëj atë...

SHKRUAN: TALHA KURTISHI

“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tuaj në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Atje do të keni çfarë t’ju dëshirojë zemra dhe çfarë të kërkonit.” (El Fussilet, 30-31)

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Allahu i Lartësuar do më shumë veprën e vazhdueshme ndonëse është e vogël”.* (Muttefekun alejhi)

Një prej vendimeve themelore të besimtarit është vendosmëria në mbajtjen dhe ruajtjen e parimeve të jetës, të cilat i ka pranuar. Besnikërinë e tij ndaj tyre ai e dëshmon çdo ditë, deri në fund të jetës së tij.

E tillë duhet të jetë edhe gjendja jonë pas Ramazanit. Por realiteti është diçka krejtësisht e kundërt. Përjetimet e Ramazanit të kaluar, adhurimet e ndërthurura me shpresën në mëshirën e Allahut dhe me frikë prej dënimit të Tij të dhimbshëm dita ditës zbehen në mjegullinë e dëshirave dhe nevojave tona të kësaj bote.

Ramazani ishte muaji i mirësisë së përgjithshme. Pas tij mbetet dilema e përshkruar mjaft bukur në fjalët e një dijetari, i cili thotë: Këtë muaj të bekuar e pritëm syçelur, me zemër të hapur, me gëzim, hare dhe shpresë. Pas ndarjes me Ramazanin zemrat tona mbushen me frikë, turp, keqardhje dhe pikëllim, sepse nuk e dimë sa ishim të singertë në të. Sa u përmbushën pretendimet që shprehëm duke thënë se do ta bëj këtë... do ta bëj atë...

Duhet ta dimë dhe të bindemi se detyrimet tona islame nuk ndërpriten me fundin e

Ramazanit, siç e ka kuptuar praktikisht shumica e myslimanëve. E thënë thjeshtë: Jeta si musliman nuk zgjat vetëm një muaj. Islami jetohet të tërë jetën me vendosmëri në adhurime dhe në largimin nga gjërat e ndaluara. Ramazani në asnjë mënyrë nuk është shpagim për vitin e kaluar në pakujdesi ndaj parimeve dhe postulateve të fesë, pakujdesi kjo e cila fatkeqësisht është bërë rutinë për shumicën dërmuese të njerëzve. Ramazani është një formë e komunikimit intensiv mes robit dhe Krijuesit të tij, komunikim ky i cili duhet të vazhdojë deri në ditën në të cilën do të na vizitojë meleku i vdekjes.

Për ta vazhduar lidhjen tonë me Ramazanin edhe pas tij, i Dërguari na porosit t'i agjërojmë gjashtë ditët e muajit Shevval. *“Kush e agjëron muajin e Ramazanit e pastaj e pason me agjërimin e gjashtë ditëve të muajit Shevval është sikur e ka agjëruar të tërë vitin”.*

Përqendrimi dhe vazhdimësia në të jetuarin me Islamit duhet të shihen në sjelljen tonë të përditshme. Sjellja jonë duhet ta vërtetojë pohimin tonë se në çdo situatë do të zbatojmë urdhrat e Allahut.

Nëse në Ramazan i kemi realizuar cilësitë e besimtarëve të vërtetë, duke agjëruar, duke u falur dhe duke luftuar me ëndjet e shpirtit, atëherë duhet të jemi mirënjohës dhe falënderues ndaj Allahut. Vendosmëria në punët e mira duhet të jetë stolja jonë edhe pas Ramazanit. Një dijetar i madh është pyetur për kerametin më të madh (nderim nga Allahu, mrekulli) dhe ky është përgjigjur: Përqendrimi në rrugën e drejtë është pikërisht kerameti më i madh. Shembull më i mirë i kësaj vendosmërie është i Dërguari i Allahut që i përballoi të gjitha frikësimet, torturat, joshjet dhe mbeti përsëri i angazhuar plotësisht në misionin e tij, që t'ua kumtojë njerëzve të vërtetën, ashtu siç ia kishte shpallur Zoti i gjithësisë. Allahu,

“Allahu është zoti i muslimanëve edhe në muajt e tjerë të vitit. Vazhdimësia në vepra të mira është shenjë e pranimi të veprave të mira...”

subhanehu te'ala thotë: *“Mos u bëni si ajo grua që e shprish dhe e bën fije-fije atë që e ka tjerë fort...”*, (En Nahl, 92) i këtillë është halli i atyre që pas Ramazanit u kthehen mëkateve, duke e lënë pas dore nënshtrimin dhe përuljen ndaj Allahut të Lartësuar. Pasi shijuan mirësitë e Islamit, ëmbëlsinë e adhurimeve dhe afërsinë e Allahut, ata u kthyen mbrapa dhe preferuan humnerën e mëkateve dhe rrezikun e hidhërimit hyjnor. Allahu është zoti i muslimanëve edhe në muajt e tjerë të vitit. Vazhdimësia në vepra të mira është shenjë e pranimi të veprave të mira. Edhe frika për mospranimin e veprave të mira është shenjë e bindjes së shëndoshë. **Të parët tanë të mirë**, gjashtë muaj pas Ramazanit bënin dua që Allahu t'ua pranojë veprat e tyre. Fedale b. Ubejdi thotë: Ta dija se Allahu ma ka pranuar një vepër të vogël sa kokrra e sinapit do të ishte më e dashur për mua se dynjaja dhe çfarë ka në të. A nuk e ke dëgjuar fjalën e të Lartësuarit, që thotë: **“Allahu pranon vetëm prej të devotshmit.”** (El Maide, 27). Maliku, i biri i Dinarit, Allahu e mëshiroftë ka thënë: Frika se një vepër nuk do të pranohet është më e madhe se vetë vepra. AbdulAziz Ebu Davudi thotë: I takova të angazhuar me vepra të mira e pastaj i kaplonte brenga a do të pranohen...

Ja disa mjete të dobishme për vazhdimësinë në vepra të mira pas Ramazanit:

1. E para dhe para së gjithash, lutja që i drejtohet Allahut për udhëzim dhe për

përqendrim në rrugën e drejtë. Allahu i lavdëron ata që i drejtohen Atij me këtë lutje: *“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen* (nga e vërteta), *pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhurues i Madh!*” (Ali Imran, 8)

2. Shoqërimi me besimtarë dhe prania më e shpeshtë në ato vende ku madhërohet dhe me lavdërime përmendet Allahu.

3. Njohja me biografitë e **të parëve tanë të mirë**, duke lexuar libra dhe duke dëgjuar ligjëratat mbi jetën e tyre.

4. Dëgjimi i ligjëratave fetare, hutbeve dhe vazeve që ngjallin emocione dhe i motivojnë besimtarët.

5. Përpikëri në kryerjen e ibadeteve të detyruara në krye me pesë namazet gjatë ditës dhe të natës.

6. Përpikëria në kryerjen e adhurimeve vullnetare.

7. Mësimi i Kuranit përmendsh dhe leximi i tij me meditim rreth kuptimeve që ngërthen

8. Përmendja e Allahut. Gjuha jote le të jetë vazhdimisht e lagët nga përmendja e Allahut.

9. Largimi nga prishësit e zemrës (shoqëria e keqe, ushqimi i ndaluar, ushqimi i tepruar etj.) dhe të gjitha format e mëkateve

Dhe në fund të porosis të nxitosh me pendimin, me pendimin e sinqertë për të kaluarën, i vendosur që asnjëherë të mos i kthehemi rrugës së mëkatimit dhe arrogancës.

Sa njerëz të këqij janë ata që e njohin Zotin e tyre vetëm në Ramazan.

Allahu është udhëzues në rrugën e drejtë. ■

FILOZOFIA ISLAME NUK EKZISTON

Aliu radijallahu anhu, thoshte: “Flitini njerëzve me atë që e kuptojnë! A mos dëshironi që ata ta mohojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij?” (Buhariu, nr. 127).

Nëse ky parim vlen për shpalljen nga Allahu i Madhërishëm, atëherë çfarë mund të thuhet për filozofinë, e cila është produkt i mendjes së kufizuar të njeriut dhe e cila në postulatet dhe parimet themelore të Fesë Islame tek njerëzit krijon huti dhe shumë dyshime.

PROF. AMIR BULIQ

Suksesin që kanë arritur gjeneratat e para muslimane në të gjitha segmentet e jetës, kanë tërhequr të gjithë analistët e paanshëm të historisë në tejkalimin e çdo suksesi të civilizimeve dhe të kulturave deri atëherë të njohura. Brenda disa dekadave fiset analfabete arabe, të cilët luftonin dhe grindeshin mes vetes u bashkuan nën flamurin islam, duke hapur kështu rrugën e të Dërguarit të fundit të Allahut dhe duke zgjeruar dritën e vërtetë të fjalës së Allahut, deri në vendet më të largëta të botës të njohura për atë kohë. Çdo



musliman ndien kënaqësi kur dëgjon për këto kohë të krenarisë dhe të lavdisë, lulëzimit dhe aftësisë, kur muslimanët merreshin si shembull për moral, shkencë, ekonomi dhe çdo lloj tjetër begatie. Ndërsa gjendja e tanishme është krejtësisht ndryshe dhe e shikuar në mënyrë të përgjithshme muslimanët janë mjaft mbrapa nga konfesionet dhe popujt e tjerë, para së gjithash nga hebrejtë dhe të krishterët, të cilët deri para disa shekujve tërhiqeshin e mahniteshin pas botës islame, si një burim i shkencës dhe i diturisë.

Përkthimet e filozofisë greke dhe fillimi i dekadencës muslimane

Gati të gjithë dijetarët islamë, të hershëm dhe të mëvonshëm, që janë marrë me studimin e shkaqeve të dekadencës dhe amullisë së muslimanëve, në mesin e shkaqeve të rëndësishme konsiderojnë edhe përkthimet e librave filozofike në gjuhën arabe, si dhe përkujdesjen për ruajtjen e tyre. Edhe pse muslimanët me literaturën dhe mësimet filozofike kanë pasur kontakte qysh gjatë shekullit të parë të hixhrit, meqë kanë pushtuar territore të ndryshme, ajo tek ata nuk kishte lënë kurrfarë ndikimi negativ mu për shkak të besimit të plotë të tyre në Kuranin dhe Sunetin, të cilat u mjaftonin plotësisht atyre. Megjithatë me kalimin e kohës u përkthyen në gjuhën arabe shumë vepra filozofike prej Aristotelit, Platonit, Pitagorës dhe paraardhësve të tjerë të kësaj fushe, të cilat lexoheshin dhe studioheshin me ëndje nga një pjesë e dijetarëve muslimanë, që më vonë do të bëhen të njohur si filozofë muslimanë, për shembull, **Farabiu** (viti 339 H), **Ibën Sina** (428 H), **Ibën Ruzhdi** (595 H) dhe të tjerë. Sujutiu pohon se personi i parë, i cili u

“Ata që punonin me përkthimin e këtyre librave shpërbleheshin bollshëm, kurse individë të shquar për çdo gram të materialit të përkthyer shpërbleheshin me po të njëjtën sasi ari...”

angazhua në përkthimin e librave filozofike në gjuhën arabe është Jahja b. Halid el-Bermekiu (vitin 190 H), që ishte njëri nga vezirët e mëdhenj në shtetin e Abasive gjatë kohës së sundimit të Harun er-Reshidit, me të cilin për një kohë të gjatë ishte shumë i afërt. Shpjegohet se **Jahja** ishte mirëinformuar për librat e filozofisë greke, që i kishte sundimtari bizantin i asaj kohe dhe që i kishte fshehur e i ruante në oda sekrete, dhe nuk lejonte që të mësoheshin për shkak frikës se për çdo rast mund të kishin ndikim negativ tek mësimet e të krishterëve. Pas refuzimeve të shumta, me ndërmjetësimin e dhuratave të cilat ia dërgonte, mbreti i Bizantit pranoi që t’ia dërgojë librat e përmendur Jahja b. Halidit, ku ky i fundit më pas mblodhi apologjetë dhe filozofë të ndryshëm, që të mësojnë dhe të diskutojnë për to. Sujuti të cilin e përmendëm më parë, në *Savmul-Mentiki* fq. 7 dhe 8 thotë: “Ka shumë pak prej atyre që u dhanë pas studimeve të këtyre librave e që arritën të mbrohen nga herezia”. Përkthimi i këtyre librave filloi në kohën e Harun er-Reshidit, ndërsa ekspansionin e vet dhe lulëzimin e plotë e përjetuan gjatë kohës së djalit të tij Abdulla b. Harunit, i njohur si Memuni. Ngjashëm me tregimet e mëparshme historianët

shënojnë se Memuni bënte përpjekje të mëdha për të arritur deri tek librat e filozofëve grekë, ndërsa pjesën më të madhe të tyre i siguroi prej sundimtarit të Bizantit. Ata që punonin me përkthimin e këtyre librave shpërbleheshin bollshëm, kurse individë të shquar për çdo gram të materialit të përkthyer shpërbleheshin me po të njëjtën sasi ari. Si shkak për një interesim aq të madh për këtë lloj literature ishte një ëndërr, që kishte parë në të cilën i ishte paraqitur një njeri shumë i pashëm me një qëndrim fisnik, i ulur në një fron, i cili ishte prezantuar si Aristoteli, ndërsa Memuni e kishte pyetur: “Çfarë konsiderohet e mirë?”, kurse ai ishte përgjigjur: “Ajo gjë që mendja e konsideron se është e mirë...” (*Ujunul-enba*, fq. 171.)

Ndikim i fuqishëm i qëndrimeve filozofike në mësimet e mu'tezelive

E shikuar globalisht është me të vërtetë për të ardhur keq, që kjo dije muslimanëve jo që nuk u ka sjellë kurrfarë dobie praktike, sikur të ndërli dhej me këtë dhe botën tjetër, por ishte njëri nga shkaqet më të rëndësishme nga largimi i rrugës së gjeneratave të para, e që padyshim shkaktoi edhe ndasi ndërmjet muslimanëve, ndasi këto që i shohim edhe sot. Njohësit e mirë të filozofisë greke me lehtësi vërejnë masën dhe fuqinë e ndikimit të saj në mësimet e shumë sekteve të devijuara islame, si fjala vjen mutezilitë, xhehmijtë e të tjerët, të cilët shumë shpesh mendimet dhe gabimet e veta i shtonin apo edhe i plotësonin e i projektonin sipas mendimeve të filozofëve të përmendur. Ebu Hasan el-Eshariu, Allahu e mëshiroftë, që në fillimet e veta ishte i orientuar nga mutezelitë, pohon se qëndrimet për Qenien e Allahut, mutezilitë i kanë marrë prej filozofëve, porse kishin frikë që ta thonë

atë haptazi, pastaj pjesërisht apo edhe plotësisht i kanë mohuar emrat dhe cilësitë e Allahut, e në këtë mënyrë ata i propagandonin qëndrimet filozofike. (*Mekkalatul-islamijjin*, f.q. 483)

“Përse të thjeshtëzohen gjërat kur bën të komplikohen”

Metoda e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, në përhapjen e fesë së Allahut dhe të dërgimit të porosive të Tij ishte e qartë dhe e padyshimtë, kështu që lirisht mund të themi se ishte edhe shumë e thjeshtë. Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, si i dërguari i fundit i Allahut iu dërgua gjithë njerëzimit, siç na njofton i Madhërishmi: **“O njerëz, unë për të gjithë ju jam Profet i Allahut...”** (El-A’raf, 158). Meqë iu dërgua të gjithë njerëzimit, ndërmjet të cilëve ka të atillë, që janë shumë inteligjentë, mesatarë dhe njerëz me aftësi të kufizuara, Muhamedi salallahu alejhi ue selem, fliste me një gjuhë plotësisht të kuptueshme, që ishte larg nga çfarëdo komplikimi apo ngatërrimi, duke u sjellë shembuj të qartë me të cilët përfitonte zemrat e njerëzve. Ndërsa me filozofët është krejtësisht ndryshe, tek ata pothuajse nuk vlen parimi: “Përse të jetë e thjeshtëzuar, kur mund të bëhet e komplikuar”, kështu që maksimalisht mundohen që çdo qëndrim apo koncept të mundshëm ta vështirësojnë apo ta komplikojnë, ndërkaq kur është e mundur që ato në mënyrë shumë të thjeshtë të shpjegohen. Kështu për shembull le të shohim se në çfarë mënyre Ibën Sina e sqaron çështjen e ekzistencës dhe pranimi të Allahut: “Ibën Sina për argumentimin e ekzistencës së Allahut i përmbahet rrugës, e cila dallohet prej asaj të sheriatit, duke pranuar dëshmi të tjera nga ato që ka sjellë Kurani... Argumenti i

Ibën Sinës mbështetet në konceptet e së **domosdoshmes** dhe **kontingjentit**. Esenca e Domosdoshme është: ekzistenca, e cila nëse paramendohet në jo-esencën e saj bëhet e pamundur. Kurse esenca e kontingjentit është ajo, kur supozohet në jo-esencën e saj bëhet e mundur, sepse Esenca e Domosdoshme si e tillë është e domosdoshme, esenca e mundshme është ajo që nuk është e domosdoshme, ajo që ka karakter të bërit e mundshme dhe e pamundshme. Esenca e Domosdoshmërisë mund të jetë nga vetvetja e domosdoshme dhe e domosdoshme nga të tjerat. Esenca e Domosdoshmërisë vetvetiu është ajo së cilës është absurde t’i supozohet jo-esenca...” (*Takvimi i viti 1984, faqe, 175-176, nga autori dr. Ahmed Fuad el-Ehvani, në përkthim të rahmetli Njazi Shukriqit*). Ta paramendojmë një imam, i cili gjatë kohës së namazit të xhumasë ngjitet në minber dhe fillon t’i flasë njerëzve për ekzistencën dhe përsosmërinë e Allahut, sipas mënyrës që e përmendëm. Jemi shumë të sigurt se askush nga xhemati i pranishëm, jo që nuk do të kuptonte asgjë, por ndoshta edhe atë që deri atëherë e dinte do t’i ndërlikohej, dhe do të mbeste i hutuar e i befasuar.

Në një nga parimet madhështore të Islamit thuhet që duhet t’i drejtohem njerëzve me zotësinë e të folurit, të cilën dëgjuesit arrijnë ta kuptojnë, madje edhe atëherë kur atyre u flitet për ajetet e Kuranit apo citohen Hadithet, burimi i të cilëve është shpallja, sepse në të kundërtën, për shkak të pamundësisë për të kuptuar atë që flisni, njerëzit do të hutohen madje ndoshta edhe do ta mohonin Allahun dhe të Dërguarin e tij. Për këtë shkak Aliu radijallahu anhu, thoshte: **“Flitini njerëzve me atë që e kuptojnë! A mos dëshironi që ata ta mohojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij?”**

(Buhariu, nr. 127).

Nëse ky parim vlen për shpalljen nga Allahu i Madhërishtëm, atëherë çfarë mund të thuhet për filozofinë, e cila është produkt i mendjes së kufizuar të njeriut dhe e cila në postulatet dhe parimet themelore të Fesë Islame tek njerëzit krijon huti dhe shumë dyshime.

Dijetarët e mëdhenj e braktisën drejtimin filozofik

Prandaj për këtë shkak themi se është gabim të flasim për ekzistencën e “**filozofisë islame**”, sepse mësimet burimore islame nuk kanë të bëjnë asgjë me filozofinë, ama tamam asgjë, por më parë duhet të thuhet se disa individë apo një grup myslimanësh gjatë historisë janë marrë me këtë lloj tematike. Një numër i madh i atyre, që notuan nëpër ujërat e diskutimeve të pakuptimta filozofike, duke u munduar të japin shpjegime për ekzistencën dhe origjinën e saj, për atomet dhe ngjarjet e paparashikuara, të pezulluar (as në tokë, as në qiell Sh. V.) nëpër sferat e metafizikës së paarritshme, në fund e kuptuan madhësinë e mashtërimeve, të cilëve u kishin kushtuar vite të tëra të jetës së tyre. Librat e historisë dhe biografisë së dijetarëve islamë janë të mbushura plot me deklaratat e atyre, që i kanë lënë mësimet filozofike dhe i janë kthyer Kuranit dhe Sunetit. Imam Raziu, Allahu e mëshiroftë, na tregon: “I studioja qëndrimet e apologetëve dhe metodat e filozofëve dhe kam vërejtur se ata as nuk e shërojnë të sëmurin dhe as të eturit nuk ia shuajnë etjen, dhe se orientimi më i mirë është orientimi i Kuranit...” Gjithashtu, në vargjet e tij të mirënjohura në mes të tjerash thotë: “*Nga hulumtimet tona jetësore asgjë nuk përfituam, përveç mbledhjes së fjalëve të kota.*”

Ibën Ebil-Iz el-Hanefiu, Allahu e

mëshiroftë, në komentin e tij në *Thëniet e Tahaviut për besimin*, përmend një numër të madh dijetarësh, siç janë Gazaliu, Amidiu, Shehristaniu, Xhuvëjni e të tjerë, të cilët janë larguar nga drejtimet filozofike, duke iu kthyer mësimëve burimore të Islamit. (*Të shikohet vepra e cituar, faqe 243-248, Tahkik Arnauti dhe Turki*).

Është për të ardhur keq, kur edhe sot në mesin e muslimanëve hasim në një plejadë të tërë personalitetesh të arsimuar në shkallë akademike, të ashtuquajtur Filozofë Islamë, të cilët literaturën tradicionale islame, siç janë për shembull koleksionet e haditheve dhe komentimet e tyre i konsiderojnë të tejkaluara dhe të pavlefshme, ndërkaq që me plot gojën flasin për rrjedhat e historisë së Filozofëve Islamë, nga mësimet e të cilëve kanë hequr dorë shumë prej atyre në qëndrimet e të cilëve këta njerëz thërrasin. E përfundojmë me fjalët e Sejid Kutubit, me të cilin pajtohemi plotësisht për këtë çështje, që thotë: “Jam i vetëdijshëm që fjalët e mia në rastin më të mirë do të shihen me çudi nga ana e shumë prej atyre, të cilët merren me të ashtuquajturën Filozofi Islame, si dhe prej atyre, të cilët në përgjithësi merren me filozofi, por unë pohoj dhe jam plotësisht i sigurt, që ky perceptim për Islamin nuk do të çlirohet nga deformimet e shëmtuara dhe të shtrembëruara, përveçse nëse neve nga Islami, nuk i braktisim plotësisht të gjitha ato që quhen filozofi dhe apologjeti islame, si dhe të gjitha ato që janë produkt i diskutimeve të ndryshme të fraksioneve islame gjatë periudhave të ndryshme kohore dhe pastaj t’i kthehemi Kuranit Fisnik...” (Të shikohet: *Hasaisut-tessavuril-islamijj*, faqe, 10-11). ■

Përshtati: Shevki Sh. Voca

KULTURA MODERNE E OFENDIMIT

Fatkeqësisht fjalimi sensibil, i balancuar dhe i mençur nuk shihet shpesh me shumë vëmendje. Në anën tjetër, ofenduesi elektronik inkurajohet nga kujdesi dhe vëmendja, që ai gjen nga të tjerët, nga të dy palët, si nga ata që e përkrahin atë ashtu edhe nga ata që e kritikojnë atë. Ai madje mund të mashtrojë veten aq shumë, sa të mendojë që ai është duke e bërë historinë!

SELMAN B. FEHD ELAUDE

Disa njerëz janë vazhdimisht të vrazhdë dhe të bezdisshëm. Ata flasin fjalë të vrazhda që nuk shfaqin ndonjë forcë argumentimi ose ndonjë dëshmi, por janë të mbushura plot me ofendime dhe sharje. I

Dërguari i Zotit, paqja qoftë me të, thotë: *“Ata që mallkojnë shumë në Ditën e Gjykimit nuk mund të jenë ndërmjetës dhe dëshmitarë.”* (Sahihu Muslimit). Gjithashtu i Dërguari i Zotit, bekimet qofshin për të, vazhdon dhe thotë: *“Besimtari nuk mund të jetë ofendues, mallkues, sharës dhe degradues”.* (Tirmidhiu, hasen).



Kushdo që e do të Dërguarin e Zotit dhe dëshiron që në Ditën e Gjykimit të jetë së bashku në shoqëri të tij, duhet të ndjekë këto shembuj të mirë. Kjo nënkupton se ai duhet ta ruajë gjuhën e tij nga të shprehurit diçka tjetër përpos asaj që është e mirë. Këshilla e të Dërguarit të Zotit, paqja qoftë mbi të, ishte që: *“...kushdo që e beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit ose të flasë mirë, ose le të heshtë”*. (Buhariu dhe Muslimi). Allahu pastë mëshirë për personin, i cili ose flet diçka të mirë dhe fiton një shpërblim, ose rri i qetë dhe mbetet i sigurt (ruhet). Nuk ka asgjë të keqe me ata njerëz që shfaqin divergjenca ose debatojnë me njëri-tjetrin veçanërisht në këto kohë të paqarta dhe të trazuara. Sidoqoftë mënyra për t'u marrë me mospajtimet duhet bërë me argumente të qarta dhe fjalë të buta. Tonaliteti i diskutimit të personit duhet të tregojë dëlirësi të qëllimeve të tij, forcë të intelektit dhe bujari të karakterit. Është e qartë për këdo, se bota islame u kaplua nga kriza të shumta. Është njësoj sikur një anije lëkundet në një stuhi dhe njerëzit në bord frikësohen se po mbyten. Zërat e tyre të gjithë përzihen së bashku. Disa zëra janë të mëshirshëm dhe të shqetësuar, disa janë të qetë, të tjerët janë të zemëruar dhe të shqetësuar. Atëherë është ky zëri që nxjerr jashtë mallkimet dhe ofendimet majtas e djathtas dhe ky zë gjithmonë e kursen veten e vet. Por, si mundet që ky zë ta mallkojë veten?

A nuk është zëri i atij, i cili dëshiron të rregullojë çështjet e secilit kur ata dorëzohen, ia kthejnë shpinën, iu dorëzohen dobësisë dhe shesin fenë e tyre për përfitime të kësaj bote? Jo ... me të vërtetë personi më i keq i mundshëm është ai që sheh vetëm të mirën në veten e tij dhe të keqen e të ligën e sheh tek gjithkush tjetër. Vëllezërit dhe motrat tona janë pjesë

e jona dhe ne duhet t'i vlerësojmë dhe t'i respektojmë ata me të njëjtin respekt siç e nderojmë ne veten tonë.

Allahu në Kuranin Fisnik thotë: ***“E përse kur e dëgjuan atë (shpifje) besimtarët të mos mendonin të mirën si për vete dhe të thoshin: ‘kjo është shpifje e qartë’”***. (Nur 12).

Allahu gjithashtu thotë: ***“O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin*** (duke nënçmuar njëri-tjetrin) ***dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen janë mizorë.”*** (Huxhurat 11).

Interneti na ka pajisur me një mënyrë të re të fyerjes dhe shpifjes ndaj njëri-tjetrit – atë të ofendimit elektronik. Tani njerëzit mund t'i shpërndajnë ofendimet dhe sharjet e tyre lirshëm pa ndonjë përgjegjësi, por pse jo edhe duke publikuar emrin e vet. Këta që angazhohen me këtë sjellje e dëshmojnë haptazi mëkatën e tyre dhe me të vërtetë që i Dërguari i Zotit, paqja qoftë me të, ka thënë: ***“I gjithë umeti im do të jenë të falur, me përjashtim të atyre që i publikojnë mëkatet e tyre”***. (Buhariu dhe Muslimi).

Interneti gjithashtu na jep mundësinë që personi të jetë anonim, të fshihet pas një emri të pavërtetë dhe kjo e lejon shpifësin t'i përshkojë të gjitha ndalesat. Fatkeqësisht fjalimi sensibël, i balancuar dhe i mençur nuk shihet shpesh me shumë vëmendje. Në anën tjetër, ofenduesi elektronik inkurajohet nga kujdesi dhe vëmendja, që ai gjen nga të tjerët, nga të dy palët, si nga ata që e përkrahin atë ashtu edhe nga ata që e kritikojnë atë. Ai madje mund të mashtrojë veten aq shumë, sa të mendojë që ai është duke e bërë historinë!

Një mundësi tjetër e re për t'i përhapur ofendimet dhe sharjet është nga telefonat celularë, me dërgimin e tekst-porositve (sms). Me mesazhe anonime, formulimet më ofensive dhe më të paturpshme mund të valëviten nëpër botë. Ky abuzim i medias elektronike është i paskrupullt dhe pa moral. Ata që shfaqin sjellje të tilla e nxjerrin veten e tyre si njerëz pa vlera, njerëz të cilët kontrollohen nga pasionet e tyre më të ulëta dhe nga zemërimi i shkujdesur, dhe që janë të motivuar nga zemërimi mendjengushtë.

Ata që mendojnë se janë duke përkrahur të vërtetën ose duke mbrojtur besimin, duke u sjellë në këtë mënyrë janë duke u mashtruar shumë. Kjo teknologji ka siguruar një mënyrë për të ofenduar dikë – dhe për ta bërë personin e lënduar të paguajë për atë.

Një shok i imi kohët e fundit mori një tekst-porosi nga dikush, që kërkonte nga ai që ta thërrasë urgjentisht. Ishte një thirrje ndërkombëtare. Shoku im e thirri atë numër dhe harxhoi mbi një orë në telefon duke dëgjuar personin tjetër duke e ofenduar dhe duke e sharë këtë. Kur ma tregoi këtë ngjarje shoku im, unë qesha dhe i thashë: 'Ai të ofendoi ty dhe ti i pagove një tarifë atij'.

Muslimanët, të cilët duan të mbahen në rrugën e drejtë në këtë kulturë të ofendimeve duhet të ndjekin këto elemente si vijojnë:

1. Ne duhet të mos ia vëmë veshin sjelljeve të tilla dhe atyre që i shfaqin këto sjellje. Kjo është pikërisht çka na thotë Kurani të bëjmë:

"... merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe largohu prej injorantëve." (Araf 199).

"Dhe kur e dëgjojnë ndonjë llomotitje marrëzie i kthejnë shpinën dhe thonë: 'Ne kemi veprat tona e ju tuajat, qofshi larg nesh, ne nuk na duhen injorantët!'" (Kasas

“...Me të vërtetë personi më i keq i mundshëm është ai që sheh vetëm të mirën në veten e tij dhe të keqen e të ligën e sheh tek gjithkush tjetër...”

55).

"Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët; ata që janë të përulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit dhe ata që i shmangen të kotës." (Muminun 1-3).

Një nga karakteristikat e të Dërguarit të Zotit, bekimet qofshin për të, ishte se sjellja e injorantëve të tjerë vetëm se e bëri atë të sillej më me butësi.

2. Ne mund t'iu përgjigjemi me diçka më të mirë. Kjo nënkupton se ne mundemi t'i lutemi Allahut për personin tjetër dhe të kërkojmë nga Allahu që ta falë atë. Ne mund të themi diçka më të mirë dhe t'ia kthejmë fjalën e keqe me një të mirë. Ky trajtim gjithashtu rekomandohet shpesh në Kuranin Fisnik: **"Ti të keqen ktheje me më të mirën. Ne e dimë më së miri atë që shpifin ata."** (Muminun 96); **"...njerëzve u thoni fjalë të mira..."** (Bekare 83); **"Atyre u jepet shpërblim i dyfishtë për arsye se bënë durim dhe ata të keqen e largojnë me të mirën, e nga ajo që Ne i furnizuem, ata japin."** (Kasas 54).

3. Ne duhet të vetëpërmbahemi dhe të jemi të qetë. Jeta është një rrugë e gjatë, dhe neve na duhet pushim dhe qetësi.

Allahu thotë: **"Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë..."** (Fet'h 4), ndërsa lidhur me të Dërguarin e Zotit, paqja dhe bekimi qofshin për të, Allahu në Kuran thotë: **"Pastaj Allahu zbriti qetësinë e vet në të dërguarin e Tij dhe në besimtarë..."** (Teube 26).

Allahu i thotë të Dërguarit të Tij, paqja qoftë mbi të: ***“Pra, të jesh i durueshëm! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Ti mos u pikëllo për ata, as mos u brengos për dredhitë që bëjnë ata!”*** (Nahël 127).

Jetoje jetën me kënaqësi e gjakftohtësi (qetësi). Kryejini punët tuaja qetësisht, me gjakftohtësi, me durim dhe me një fytyrë të hareshme - qoftë ajo tregti, industri, punë islame, menaxhment ose çkado qoftë tjetër, që Allahu ju ka caktuar për ju në këtë botë. Mos ia vini veshin atyre zërave që synojnë t'ju ulin dhe nënçmojnë.

4. Nuk duhet ta humbim kohën duke u përgjigjur dhe duke përgënjeshtruar atë që thonë ata. Lërja ato të tjerëve. Jo gjithçka që ne themi është doemos korrekte dhe jo gjithçka që të tjerët flasin është gabim. Ne duhet ta përmbajmë veten nga ofendimet dhe sharjet.

Dikush më pyeti një herë: “Pse nuk shkruani një replikë kështu dhe kështu, meqë folën keq për ty në gazetë?” Unë ia ktheva: “Kam gjëra të caktuara për të bërë dhe zgjedh të mos merrem me atë. Por po supozojmë se po e replikoj atë. Pastaj ai do të shkruajë një replikë tjetër kësaj times. A duhet atëherë t'i braktis të gjitha përpjekjet e mia produktive dhe t'i përkushtohem një beteje fjalësh?

Ose a duhet të ndaloj dhe t'i duket vetja oponentit tim se ka fituar? Pastaj fillova të mendoj për këto debate që u zemëruan midis individëve 30 ose 40 vite më herët - pa përmendur ato që ndodhën shekuj më parë. Cili ishte efekti përfundimtar i tyre? Çfarë arritën ata? A nuk do të ishte më mirë për mua t'i shpenzoj përpjekjet e mia të kufizuara në diçka më të fortë, më të qëndrueshme dhe më me vlerë?

5. Ne nuk duhet asnjëherë që t'i lëmë armiqtë tanë dhe panjerëzitë e të tjerëve të na nxisin në mohimin e së vërtetës, duke

folur pavërtetësi ose duke ngulmuar në një gabim.

Ne duhet t'i bëjmë një vetë-vlerësim dhe vetë-korrigjim veseve tona.

Njerëzit shpesh kritikojnë kuptimin e dukshëm se çfarë po thoni pa i vlerësuar të gjitha aspektet e saj.

6. Ne duhet të kujtojmë se i kemi bërë male mëkatet tona. Ne kemi shikuar pamje të ndaluara. Ne kemi thënë diçka që nuk duhet ta themi. Ne kemi qenë mospërfillës në detyrat tona. Allahu me Mirësinë e Tij ndaj nesh zgjodhi për ne vuajtjet më të lehta të kësaj bote për të shlyer nga ne mëkatet tona, ose për ta lartësuar statusin tonë, për të na ngritur drejt lartësive që ne asnjëherë nuk kishim mundur t'i arrinim ato vetëm me veprat tona të mira.

Allahu cakton për ne ata që mendojnë të jenë kundërshtarët tanë, por në realitet ata janë ndihmësit tanë, përmes të cilëve ne arrijmë mëshirën e Allahut. Kjo nuk nënkupton se shpërblimi jonë vjen në kurriz të tyre. Allahu është shumë bujar. Kundërshtari jonë mund të fitojë mëshirën e Allahut për sinqeritetin dhe nderin e tij - madje edhe pse ai mund të jetë gabim - gjersa ne jemi shpërblyer për durimin tonë. Ne nuk duhet të shohim avancimin (përparimin) tonë në kurriz të të tjerëve.

Ne duhet ta lusim vazhdimisht Allahun për falje, kushdo që vepron kështu, do të gjejë se Allahu do t'i dhurojë atij qetësi, ndihmë dhe lehtësim për çdo shqetësim dhe do ta nxjerrë nga çdo vështirësi, dhe Ai do t'i japë për nevojat e tij nga ajo që njeriu kurrë nuk mund ta imagjinojë. Vërtetë, Allahu është me ata të cilët bëjnë durim. ■

Përshtati nga anglishtja: Fitim NUHIU

TI JE PENGESË PËR FITOREN E MUSLIMANËVE

ABDULKERIM AL-KATEB

I ulur në vetmi, i brengosur me lajmet që vijnë nga muslimanët dhe fatkeqësitë që po iu ndodhin atyre, dëgjova një zë nga brenda meje që më thoshte: Ti je njëri nga fajtorët. Ti je arsyeja pse ne nuk e arrijmë fitoren. Ti je faktori kryesor për atë me të cilën po përballen muslimanët sot.

Unë iu përgjigja: Unë? Si ka mundësi? Unë jam vetëm një rob i dobët i Allahut, një rob që nuk ka forcë në duart e tij. Nëse unë e provoj t'i urdhëroj njerëzit, ata kurrë nuk do të me dëgjojnë, madje edhe nëse e provoj t'i këshilloj, ata nuk do ta marrin parasysht këshillën time.

Me shpejtësi ky zë ma ktheu duke më ndërprerë: Janë mëkatet e tua, që e kanë rraskapitur melekun, që është në anën tënde të majtë. Ai është mërëzitur duke shkruar mëkatet në librin tënd. Dita dhe nata jote është në betejën e mosbindjes ndaj Allahut. Është largimi yt nga veprat e mira dhe veprimi i mëkateve.

Unë: Çfarë kam bërë që më fajëson për gjithë këtë mua e të më thuash, se unë jam pengesë për fitoren e muslimanëve?

Brendia ime: Rob i Allahut, për emër të Allahut, nëse filloj t'i numëroj çfarë ke bërë do të më marrë shumë kohë. Por me lejo të të pyes: A e fal namazin e sabahut me xhemat?

Unë: Po, ndonjëherë, por më shpesh mungoj.

Brendia ime: E sheh! Këtu është problemi,

ti kundërshton vetveten. Si pretendon se mund të shkosh në xhihad, kur ti dështon në xhihadin me nefsin tënd, kur dihet se xhihadi me veten tënde nuk të kushton me jetë apo me para? Të kushton vetëm disa minuta për të falur dy rekat namaz, që janë detyruar nga Allahu. Si mund të thërrasësh për xhihad, kur ti nuk e praktikon faljen e pesë kohëve të namazit? Kur ti nuk mund të falësh namazet sunete? Kur nuk lexon së paku disa ajete nga Kurani për çdo ditë? Kur ke harruar për dhikrin e mëngjesit dhe të mbrëmjes? Kur nuk mund ta ndalosh veten nga shikimi i asaj që Allahu e ka ndaluar? Kur nuk je i sjellshëm me prindërit e tu? Kur nuk mban lidhje të mira me të afërmit tuaj?

Si mund të thërrasësh për zbatimin e sheriatit në vendin tënd, kur ti nuk e zbaton atë në veten dhe familjen tënde? Ti nuk e ke frikë Allahun në sjelljet me familjen tënde, ti nuk i ndihmon ata në pasimin e besimit të vërtetë, ti nuk brengosesh për furnizimin e tyre me paratë që vijnë nga fitim hallall. Dhe duke vepruar kështu bëhesh nga ata njerëz për të cilët Allahu ka thënë: *“Dhe ju e doni bollëkun (pasurinë e shumtë) me një dashuri të tepruar. Pra, ju keni gënjer, mashtruar dhe thyer premtimin, tani meritoni dënim nga Allahu.”*

Unë: (e ndërpreva) Dhe çfarë ka të bëjë kjo me fitoren? A mundet që një musliman të pengojë fitoren e tërë umetit?

Brendia ime: Posi!!! Natyrisht, kështu si ti janë qindra milionë – me përjashtim të atyre që i ka mëshiruar Allahu, subhanehu ue teala,

“Mos fillo të thërrasësh për zbatimin e sheriatit përveç nëse je shembull për të mirë në zbatimin e sheriatit në shtëpinë, në punën tënde dhe kudo...”

po ata janë me qindra milionë që kanë mendime të njëjta si ti. Ata nuk brengosen për t’iu bindur Allahut. Ata nuk i frikësohen Allahut dhe e kërkojnë fitoren me arsyen, se ka muslimanë të tjerë që janë besimtarë më të mirë. Por e vërteta e dhimbshme është se ata të gjithë janë po aq të këqij – përveç atyre mbi të cilët Allahu ka lëshuar mëshirë. A nuk e di, o rob i Allahut, se kur shokët e Pejgamberit, salallahu alejhi ue selam, kërkuan fitoren dhe nuk e arritën atë, ata e kuptuan se ndërmjet ushtrisë së tyre ishte dikush që kishte bërë një punë të keqe.

E si do të jetë puna me umetin, që është zhytur në të gjitha llojet e mëkateve, të vogla e të mëdha. A nuk e sheh çfarë po i ndodh umetit nga lindja e deri në perëndim?

I prekur thellësisht, me lot në sy, për atë që asnjëherë nuk e kisha marrë me mend që unë, njeriu që e do Allahun dhe Profetin e Tij, që e do Islamit dhe të gjithë muslimanët mund të jem një nga arsyet e dështimit të muslimanëve. Që unë mund të jem pjesëmarrës në lumin e gjakut të muslimanëve të pafajshëm në shumë vende islame.

Gjithnjë ka qenë e lehtë për mua të fajësoj një udhëheqës, princ, ministër ose dikë përgjegjës në shtet, por asnjëherë nuk kam menduar fillimisht për gabimet e mia dhe asnjëherë nuk kam menduar çfarë ka thënë Allahu: **“...Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete...”** (Kurani 13: 11)

Ashtu që unë i thashë vetes: Falënderimi i

takon Allahut që më dha këtë shpirt vetëqortues. Pastaj e pyeta: Çfarë më këshillon të bëj?

Brendia ime: Fillo me veten tënde. Kryej rregullisht faljen e pesë kohëve të namazeve të detyrueshme, paguaj zekatin, agjëro Ramazanin, kryej haxhillëkun, urdhëro për të mirë dhe ndalo nga e keqja, bëhu i sjellshëm me prindërit, përpiku të jesh afër Allahut duke falur namaze sunete. Shfrytëzo çdo mundësi për të qenë afër Allahut, duke mos i anashkaluar veprat si të parëndësishme. Kujtoje se një buzëqeshje në fytyrën tënde është sadaka. Mos kërko nga njerëzit të bëjnë asgjë, të cilën ti vetë nuk e praktikon. Mos fillo të thërrasësh për zbatimin e sheriatit përveç nëse je shembull për të mirë në zbatimin e sheriatit në shtëpinë, në punën tënde dhe kudo. Mos kërko nga udhëheqësit, që të shpallin xhihad, kur ti ke dështuar në xhihadin me veten tënde. Mos iu shmang përgjegjësisë duke fajësuar të tjerët. Ndrysho në fillim veten, pastaj të tjerët do të të pasojnë. Bëhu shembull i mirë kudo që të shkosh. Nëse e shpenzon kohën duke fajësuar të tjerët të lutem ndalu – faleminderit shumë- Allahu të shpërbleftë- por është bërë aq shumë kritikë tashmë. Gjithmonë fillo duke ndryshuar vetveten. Pas kësaj lute Allahun singërisht për të dhënë fitoren dhe për të ndihmuar të gjithë myslimanët, që janë pasues të sunetit. Në këtë mënyrë ti do të jesh ndërmjet atyre që Allahu i ka përmendur në Kuran: **“O besimtarë, nëse ju ndihmoni fenë e Allahut, Ai ju ndihmon juve dhe ua forcon këmbët.”** (Kurani Fisnik 47: 7).

E drejtoj fytyrën time nga Allahu, duke e lutur për falje dhe duke i fshirë lotët them: O Allah: Jam penduar. Unë jam kthyer tek Ti, lejo të hapet për mua një faqe e re, një jetë e re, të cilën do ta filloj me dy rekate namaz në mes të natës, duke t’u lutur që të më bekosh gjithmonë me namazin e natës.

Përktheu nga anglishtja: Bujar GJIKOKAJ

SQARIMI I SHIRKUT NGA DIJETARËT E MËDHENJ HANEFIJ

Shirku me të gjitha format e tij nuk është gjë tjetër vetëm se bela për njeriun dhe poshtërim për të, sepse ai kështu i nënshtrohet dhe i përulet krijesave, të cilat nuk zotërojnë dobinë e as dëmin e tyre.

SHKRUAN: BLEDAR HAXHIU

Falënderimet më të larta i takojnë Allahut, paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi vulën e profetëve dhe zotërinë e njerëzimit, Muhamedin, mbi familjen e tij të nderuar, shokët e tij besnikë dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Shumë njerëz mendojnë se dijetarët hanefij nuk i kanë kushtuar vëmendje çështjes së Teuhidit dhe besimit, por në realitet kush shfleton librat e tyre gjen përpjekje të panumërta në lidhje me sqarimet e bëra nga ata për umetin islam. Pjesët që do të sjellim më poshtë e vërtetojnë shumë mirë një fakt të tillë.

Përkufizimi i shirkut tek dijetarët hanefij:

Imam Abdulkadir Dehleui, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Shirk është të besosh se dikush përveç Allahut meriton ndonjë prej cilësive të Tij, si p.sh. të thotë: Filani di çdo gjë; apo se filani ka në dorë të mirën dhe të keqen; apo t’i kushtojë ndonjë vepër adhurimi dikujt tjetër në vend të Allahut, sikurse të bjerë në sexhde apo ta lusë për nevojat”.

Ndërsa **imam Muhamed Ismail Dehleui**, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Shirk nuk është vetëm fakti që njeriu të barazojë dikë me Allahun pa asnjë lloj ndryshimi! Përkundrazi, realiteti i shirkut është që

dikush të vijë me vepra dhe gjëra, të cilat Allahu i ka veçuar vetëm për Të dhe të cilat i ka bërë simbole të adhurimit të Tij, e t’ia dedikojë dikujt, sikurse t’i bjerë në sexhde dikujt, të presë kurban me emrin e tij, apo të betohet në të, t’i kërkojë ndihmë atij kur është në vështirësi, apo të mendojë se ai është i pranishëm dhe se vepron në gjithësi. Të gjitha këto janë shirk dhe ai që i kryen konsiderohet mushrik (Idhujtar)”.

Llojet e shirkut tek dijetarët hanefij


Siç do ta shohim më poshtë, dijetarët hanefij në librat e tyre kanë përmendur disa lloje shirkut që gjendeshin në shoqëritë muslimane të asaj kohe, normalisht nuk i kanë përmendur të gjitha, porse ajo që na intereson neve, është fakti se këta dijetarë janë përpjekur realisht për zbardhjen e një fakti të tillë; shirku i cili është gjynahu më i madh që është bërë në tokë.

Tehaneui ka përmendur disa lloje shirkut, ku thotë: “Shirku është në disa forma, prej tyre:

Shirku në adhurim, Allahu thotë: *“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!”* (Nahël, 36)

Shirku në bindje, në emërtim, Allahu thotë: *“Mos hani asnjë mish që nuk është therur me emrin e Allahut, sepse kjo është gjynah!”* (En’am, 121).

Shirku në dije, Allahu thotë: *“Vetëm Ai e*



di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt". (Xhin, 26).

Si dhe shirku në fuqi, Allahu thotë: **"Në të vërtetë, ata që ju i adhuroni në vend të Allahut, nuk kanë pushtet t'ju furnizojnë"**. (Ankebut, 17).

Ndërsa Muhamed Ismaili ka përmendur një numër të konsiderueshëm veprash, të cilat janë shirk dhe prej tyre janë: **Shirku i lutjes së eulijave** dhe kërkimi i mbrojtjes prej tyre. **Shirku i zotimit** dhe prerjes së kurbanit për eulijatë. **Shirku në emërtim**, duke ia atribuar fëmijët eulijave, pra, se ata janë dhuratë nga ata e jo nga Allahu, kështu që i emërtojnë me emrat e tyre. Shirk është edhe **betimi për dikë tjetër** në vend të Allahut; **lidhja e fijeve** (nuskave), të cilat kanë emra të eulijave në duart apo këmbët e fëmijëve (duke besuar se një gjë e tillë do t'i ruajë nga mësyshi etj).

Rrugët që të çojnë në shirk prej të cilave kanë tërhequr vërejtjen dijetarët hanefij

Dijetarët hanefij si të gjithë dijetarët e medhhebeve të tjera kanë deklaruar hapur

ndalimin e kryerjes së veprave, të cilat janë rrugë për shirkun, si lyerja e varreve dhe ngritja e tyre si ndërtesa, marrja e tyre si faltore, ndriçimi i tyre, lutja e Allahut në to, marrja e tyre si vend festash, si dhe ndërmarrja e udhëtimeve për të shkuar tek ato. **Muhamed Alaudin elHaskefiu** ka thënë: "Dije se zotimet dhe premtimet që bëjnë shumica e njerëzve të thjeshtë për të vdekurit, çuarja e qirinjeve, parave apo të tjera si këto nëpër varret e të ashtuquajturve **njerëz të mirë** që të afrohen tek ata, është vepër e paligjshme dhe e ndaluar sipas mendimit unanimit të gjithë dijetarëve.

Ndërsa **Imam Ibën Abidini** duke komentuar fjalët e mësipërme ka thënë: Thënia e imamit "që të afrohen tek ata" sikurse të thotë tek varri (apo t'i drejtohet të vdekurve): Nëse ma kthen të humburin, apo nëse ma shëron të sëmurin, do të jap për ty kaq flori, argjend, lek, ushqim, qirinj, etj. Pra, ky është një zotim dhe zotimi është adhurim, që nuk duhet t'i atribuohet krijesës, porse Allahut, sepse krijesa nuk zotëron gjë.

“Pra, ky është një zotim dhe zotimi është adhurim, që nuk duhet t’i atribuohet krijesës, porse Allahut, sepse krijesa nuk zotëron gjë...”

Imam Alusiu gjatë komentimit të ajetit kuranor: ***“Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë. Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë, përveç Tij, duke thënë: “O njerëz, është sjellë një shembull, prandaj dëgjojeni atë: ‘Idhujt që ju i adhuronin në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe nëse bashkohen të gjithë për këtë. E, nëse miza u merr atyre diçka, ata nuk do të mund t’ia marrin. I dobët është përgjëruesi (adhuruesi), por edhe ai të cilit i përgjërohen (idhulli)’.”*** (Haxh, 73), ka thënë: Nuk ka dyshim se pretendimet e atyre që lusin dhe u drejtojnë hallet dhe shqetësimet e tyre, të ashtuquajturit njerëz të mirë janë njësoj me pretendimet e idhujtarëve, të cilët thoshin: ***“Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu”***. (Zumer, 3).

Ndërsa në një vend tjetër ka thënë: “Kam parë njerëz që lejojnë atë që bëjnë injorantët në varret e të ashtuquajturve njerëz të mirë, si: ngritjen e tyre, ndriçimin e tyre, faljen e namazit në to, bërjen e tavafit (rrotullimin rreth varrit), grumbullimin tek ato në kohë të veçanta etj. Të gjitha këto janë kundërshtim i Allahut dhe të Dërguarit të Tij, si dhe janë bidate, të cilat nuk i ka urdhëruar Allahu. Do të të mjaftonte për të kuptuar të vërtetën rreth këtyre fenomeneve po të shikoje se si vepruan shokët e Profetit me to dhe si u sollën me varrin e Profetit. Krahasoji ata dje, e krahasoji njerëzit sot! Allahu të udhëzoftë

tek e drejta”.

Imam Ismail Ed-Dehleui ka thënë: “Dije se shirku është përhapur shumë tek njerëzit, ndërsa Teuhidi është bërë si diçka e huaj. Shumica e njerëzve sot nuk e njohin domethënien e shirkut, ata pretendojnë se besojnë, ndërkohë që janë të njollosur dhe të përlyer me shirk. Është me të vërtetë e rëndësishme që njerëzit përpara çdo gjëje të njohin shirkun dhe Teuhidin dhe gjykimin e tyre në Kuran dhe Hadith”.

Lexues i nderuar, këto ishin disa shkëndija të shkëputura nga libra të dijetarëve hanefij, të cilët janë përpjekur për t’u sqaruar njerëzve çështjen më të madhe për të cilën Allahu ka zbritur Librat, ka dërguar profetët dhe ka krijuar Xhenetin e Zjarrin, kanë folur në to për Teuhidin dhe shirkun, në mënyrë që njerëzit t’i njohin e të jenë të kujdesshëm që të mos bien në gjërat, të cilat i kryenin injorantët përpara ardhjes së Islamit.

Në përfundim të këtij shkrimi mund të përmendim rezultatet më të rëndësishme:

1- Dijetarët Hanefi kanë bërë përpjekje që meriton falënderim dhe mirënjohje në lidhje me sqarimin e shirkut dhe llojeve e formave të tij, si dhe për kritikën që i kanë bërë shpikësve në fe dhe adhuruesve të varreve.

2- Shumica e muslimanëve sot për fat të keq nuk e njohin realitetin e Teuhidit ndaj dhe kanë rënë në shirk duke mos e kuptuar as ata vetë.

3- Shirku me të gjitha format e tij nuk është gjë tjetër vetëm se bela për njeriun dhe poshtërim për të, sepse ai kështu i nënshtrohet dhe i përulet krijesave, të cilat nuk zotërojnë dobinë e as dëmin e tyre.

Si përfundim, e lusim Allahun të na ruajë nga shirku dhe format e tij e të na bëjë prej atyre që adhurojnë vetëm Allahun e që të tillë të jemi deri në vdekje. ■

“O TË RINJ, MARTOHUNI”

Jeta është e paqartë, shpirti është i vetëm dhe njeriu është axhami përderisa nuk martohet.

SHKRUAN: OMER BERISHA

Martesa nga shumë njerëz përçmohet, megjithëse është një nga ndodhitë më të mira për njeriun. Pse vallë të ndodhë kjo? Shumë të mençur janë munduar t'i japin përgjigje kësaj çështje, ndërsa përgjigjja më e mirë që kam mundur të kuptoj është se ata që flasin ashtu janë ata që i janë rebeluar natyrshmërisë me të cilën na ka krijuar Allahu. Ai rebelim i çoi ata të japin mendimin ndryshe, të thonë se martesa i shton detyrat dhe asgjë tjetër, martesa të burgos dhe të mbyt... vetëm e vetëm të formojnë një shoqëri që nuk i njeh vlerat e familjes dhe shoqërisë njerëzore. Por realiteti i shumicës së këtyre njerëzve na dëshmon gabimin e tyre, sepse shumë prej tyre tanimë kanë zgjedhur për shok të jetës vetminë, sepse “s’ka grua (burrë) për të”, të tjerë kanë zgjedhur shishen, i treti ndonjë këlysh... por – Zoti na ruajt – ka edhe të atillë, të cilët e shfrytëzuan “lirinë” seksuale dhe tani treten dhe krimben duke pritur vdekjen dita ditës, sepse vetëm atë ditë do të lirohen nga “burgu” famëkeq ndërkombëtar i “AIDS”.

Ky botëkuptim për martesën është i rrezikshëm dhe për muslimanët është i papranueshëm. Përkundrazi Islami e nxit martesën dhe inkurajon formimin e familjes. Muhamedi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“O të rinj, kush ka mundësi të martohet le të martohet, sepse kështu e ruan më mirë syrin dhe e mbron organin e tij. E kush nuk mundet të martohet, le të agjërojë, sepse*



*agjërimi është mburojë për të*¹. Ky hadith njëherazi na tregon edhe vlerën e ndershmërisë së besimtarit, të cilën duhet ta ruajë, ose me martesë, ose me agjërim, sepse njeriu pa ndershmëri, nuk di të respektojë e as të ndihmojë, e lëre më të dashurojë. Dikush nga besimtarët e hershëm pati dëshirën të mbetet i pamartuar, me qëllim që të tërë jetën t'ia kushtojnë adhurimit ndaj Allahut. Por i Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të, i ndaloi nga murgjëria dhe i urdhëroi të martohen, duke ju thënë: *“Martoni ato gra që lindin dhe dashurojnë, sepse në Ditën e Kiametit do të krenohem me numrin e madh të umetit tim”*².

A është martesa detyrim (farz)

Dispozita për martesën ndryshon varësisht nga gjendja e njeriut:

Është farz për atë njeri, i cili ka mundësi të martohet, ka epsh dhe ka frikë se do të bjerë në zina (lidhje jashtëmartesore). Për këtë njeri është farz martesa, sepse mbrojtja nga harami dhe të qenit i ndershëm janë gjëra të pandara nga besimtari. A nëse nuk ka mundësi materiale të martohet, por ka epsh, atëherë le ta ndihmojë ndershmërinë e tij me agjërim dhe le të lexojë fjalën e Allahut të Lartësuar: *“...dhe le të jenë të ndershëm ata që nuk kanë mundësi të martohen derisa Allahu t'u japë pasuri”*. (Nur 33). Këtu kemi si qëllim atë që nuk zotëron as kushtet minimale, përndryshe nëse ka një vendbanim modest dhe është i aftë për punë, këtij i themi fjalën e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: *“Tre njerëz Allahu i mori për detyrë t'u ndihmojë... – ku përmendi – ...dhe ai që martohet për të ruajtur ndershmërinë”*.

Është mustehab (e pëlqyer) për atë njeri, i cili ka mundësi të martohet dhe ka epsh, por

“...Njeriu pa ndershmëri, nuk di të respektojë e as të ndihmojë, e lëre më të dashurojë....”

është i sigurt në vetvete nga rënia në haram. Është e pëlqyer që ky njeri të martohet dhe duhet ta dijë se martesa për të është më e mirë sesa të bëjë ibadete vullnetare dhe gjithashtu nuk duhet të harrojë se murgjëria është rreptësisht e ndaluar.

Është haram (e ndaluar) për atë njeri, i cili nuk ka mundësi të bëjë mbikëqyrjen e të shoqes, ose nuk ka mundësi të ketë marrëdhënie intime me të. E njëjta gjë vlen edhe për atë grua që nuk mundet t'i plotësojë kërkesat e bashkëshortit.

Është mekruh (e urryer) për atë njeri, i cili nuk ka mundësi të bëjë mbikëqyrjen e të shoqes, ose nuk ka mundësi të ketë marrëdhënie intime me të, mirëpo këtë e bëjnë me pajtim dhe informim paraprak. Pra, ka mundësi ndonjë grua që është e pasur, merr përsipër harxhimet shtëpiake dhe pajtohet me paaftësinë e burrit për jetë intime. Kjo martesë është e urryer, për shkak se ata të dy preokupohen me detyra dhe angazhime, prej të cilave nuk do ketë asnjë fryt, madje do t'i privojë edhe nga adhurimi dhe punët e mira.

Është mubah (e lejuar) për atë njeri, i cili s'ka asnjë pengesë të martohet, por as që e tërheq martesa.

Para fejesës

*“Martesën me një grua e bëjnë katër gjëra: pasuria, soji, bukuria dhe feja. Merre atë që është me fe, të lumshin duart”*³. Le të jetë ky

¹ Buhariu nr. 1905; Muslimi nr. 1400

² Ahmedi 3/158

³ Buhariu nr. 5090

hadith parimi jonë, kur jemi duke kërkuar njeriun me të cilin duam të ndajmë jetën së bashku. Shumë gjëra me të cilat ndeshet familja, nuk i zgjidh dot pasuria, as soji e as bukuria. Prandaj kërko dhe lute Allahun të ta mundësojë gjetjen e asaj/atij, që i është përkushtuar respektimit të Allahut.

Nëse këtë e gjen, atëherë është mirë (sunset) që ta shikosh atë, sepse Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Nëse ndonjëri nga ju dëshiron ta fejojë një grua dhe ka mundësi të shohi nga ajo diçka që do ta tërhiqte për martesë, le ta bëjë pra”*.⁴

Kushtet që lejojnë shikimin e një femre janë:

1. Të bëhet në prani të dikujt, një të treti, pra, të mos jenë vetëm ata të dy.

2. Të mos bëhet me epsh, e nëse e shikon me epsh ai ka bërë haram, sepse qëllimi i këtij shikimi është ta njohë pamjen e saj, e jo t'i kënaqë sytë.

3. Të besojë në një përgjigje pozitive nga ajo dhe prindi i saj.

4. Të shikojë ato pjesë që i shfaq ajo zakonisht para anëtarëve të familjes së saj, sikurse fytyra, qafa, duart dhe të ngjashme.

5. Të jetë serioz dhe i vendosur ta bëjë këtë fejesë, por ama, nëse bredh nga një shtëpi në një tjetër për të shikuar gra, kjo nuk është e lejuar.

6. Kjo vlen për gratë. Kur të dali para tij, nuk guxon të dali e zbuluar, e zbukuruar dhe e parfumuar, sepse nuk është ky qëllimi, pra, ta tërheqësh dhe ta hutosh atë me zbukurimet dhe parfumet e tua.⁵

Nëse i pëlqen dhe djaloshi e zyrtarizon kërkesën e tij deri te prindi i vajzës, atëherë vajzës dhe prindit (përgjegjësit) të saj i

përkujtojmë hadithin: *“Nëse ju vjen (për t’ju kërkuar) ndonjëri me moral dhe përkushtim ndaj fesë, gjëra të cilat ju pëlqejnë, atëherë martojeni, përndryshe, do të bëhet fitne në tokë dhe çrregullime të gjera”*.⁶

Rregullat e vënies së kurorës

Që kurora (nikahu) të jetë i vlefshëm duhen plotësuar këto rregulla:

1. Ata që do të martohen duhet të jenë pajtuar me njëri-tjetrin e kurrresi të detyruar. Këtë na e mëson i Dërguari, paqja dhe lavdërimi qoftë mbi të: *“E veja martohet vetëm nëse ajo kërkon, kurse beqarja martohet vetëm nëse ajo lejon”*.⁷

2. Nëse gruaja pajtohet, gjithashtu duhet të pajtohet patjetër edhe prindi i saj, përndryshe kurorëzimi mbetet i pavlefshëm.

3. Prania e dëshmitarëve. Pra, në çastin që prindi i vajzës (përgjegjësi) apo i autorizuari nga ai, ia drejtojnë **ofertën** djalit apo dikujt të autorizuar nga ai (me këtë përmbajtje p.sh. A do ta martojë Abdullahu i biri i Muhamedit, Ajshen të bijën e Bujarit?), dhe ai **pranon** (me këto fjalë p.sh. Po, do ta martojë; Po, pranoj), duhet të jenë të pranishëm së paku dy dëshmitarë të drejtë muslimanë dhe të rritur. Prania e këtyre dëshmitarëve është e domosdoshme, përkundrazi kurorëzimi mbetet i pavlefshëm. Argument për këtë kusht dhe kushtin para këtij është hadithi: *“Nuk ka kurorëzim të vlefshëm pa u pajtuar përgjegjësi dhe pa qenë të pranishëm dy dëshmitarë të drejtë”*.⁸

4. Mehri ose dhurata e kurorëzimit. Ajo është një pasuri që burri detyrohet t’ia japë gruas për shkak të kurorëzimit me të. Mehri është detyrim që duhet plotësuar dhe jo

⁴ Sahihul Xhamië nr. 506 – hasen.

⁵ Këto kushte i ka përmendur dijetari Muhamed b. Utthejmin në librin “Sherhul Mumtië” 12/22

⁶ Sahih Ibën Maxhe nr. 1614 – hasen.

⁷ Sahih Ibën Maxhe nr. 1537

⁸ Sahihul Xhamië nr. 7557

anashkaluar. Allahu i Lartësuar thotë: ***“...dhe jepuni me gjithë zemër grave tuaja dhuratën e kurorëzimit”***. (Nisa 4). Sasia e mehrit nuk është e kufizuar, por parapëlqehet të mos jetë ndonjë shumë e madhe, që do t’ia vështirësonte burrit pagesën. Pagesa e mehrit mund të bëhet menjëherë pas kontratës së kurorëzimit, ose të vonohet deri në një afat të caktuar. Kur ta bëjë bashkëshorti këtë pagesë, mehri mbetet pronë e gruas dhe të drejtën e shfrytëzimit të asaj pasurie nuk e ka askush tjetër pos saj, as babai e as burri i saj.

Pas plotësimit të këtyre rregullave themi se ata të dy janë burrë e grua, të cilët së shpejti do të bëjnë dasmën dhe kështu do të shpallin martesën e tyre.

Disa çështje me rëndësi

- Pas kurorëzimit dhe para dasmës çfarë u lejohej atyre të dyve?

Nëse një burrë dhe grua i plotësojnë këto kushte që përmendëm deri tani, ata konsiderohen bashkëshort dhe bashkëshorte. Mes tyre është e lejuar gjithçka: shikimi, vetmia, ledhatimi dhe marrëdhëniet intime⁹, sepse Allahu subhanehu ue teala, ka thënë: ***“...dhe ata që i ruajnë organet e tyre përveç ndaj bashkëshortëve/eve të tyre”***. Bashkëshortësia mes tyre është e vërtetuar që nga kurorëzimi i tyre, prandaj nëse njëri prej bashkëshortëve vdes pas kurorëzimit, e drejta e trashëgimisë i pohohet tjetrit edhe pse ende nuk e kishin bërë dasmën.

Tek ne, këtu kam si qëllim Ballkanin në përgjithësi, besimtarët e kanë zakon të bëjnë dallim midis shpalljes së kurorëzimit dhe shpalljes së dasmës dhe vetëm pas kësaj të dytës iu lejohej marrëdhëniet intime. Këtë dallim e kanë bërë jo pse ka ndonjë argument, por me qëllim që të mbetet një hapësirë kohore derisa burri të përgatisë shtëpinë e tij dhe gruaja çejzin e saj. Pra, tanimë tek ne

njohim fejesë (kurorëzimi) dhe martesë (dasma). Përderisa është kështu, themi se ata nuk duhet të kenë marrëdhënie intime, për shkak të problematikave që mund të lindin, sikurse shtatzënia, akuzat ndaj femrës – sepse jo të gjithë e njohin se është gruaja e këtij personi.

- Nëse një çift bashkëshortor jomuslimanë bëhen muslimanë

Ibën Kudame ka thënë: “Kurorëzimet e jobesimtarëve janë të vlefshme dhe nëse ata pranojnë Islamin, kurorëzimet e tyre nuk përsëriten... nuk ka nevojë të shikohet sesi e kanë bërë kurorëzimin, a i kanë plotësuar kushtet ose jo... për këtë nuk ka asnjë divergjencë në mes myslimanëve. Ibën AbdulBeri ka thënë: Dijetarët pajtohen njëzëri për rastin nëse një çift e pranojnë njëherazi Islamin, se kurorëzimi i tyre është i vlefshëm, përveç nëse janë familje nga gjaku ose gjiri...”.

- Regjistrimi i kurorëzimit zyrtarisht

Për të qenë një martesë e vlefshme duhen plotësuar ato që përmendëm më lart: pajtimi i bashkëshortëve, leja e përgjegjësit të gruas, prania e dy dëshmitarëve dhe dhënia e mehrit. Pas plotësimit të këtyre, kurora e tyre quhet e vlefshme. Ndërsa regjistrimi zyrtar bëhet për shkak të shfrytëzimit të disa të drejtave zyrtare. Pra, nëse merren vesh që kurorëzimi të mbetet vetëm ashtu si thamë ndërsa regjistrimin do ta bëjnë më vonë, kjo nuk prish asgjë. Por të bëhet regjistrimi sa më parë është më mirë, sepse nuk i dihet situatave, ku domos duhet të kesh certifikatën e kurorëzimit.

- “Kurorëzimi formal”

Me kurorëzim formal kam si qëllim ato kurorëzime, që në realitet nuk janë kurorëzime, por janë vetëm certifikatë, bojë mbi letër. Kurorëzohen në letër, por në realitet ata s’janë burrë e grua, nuk jetojnë bashkë, madje ndoshta edhe nuk njihen. Këto ndodhin zakonisht për përfitime materiale, për të regjistruar ndonjë firmë, për të fituar ndonjë

⁹ El Fetaval xhamiah lil mer’etil muslima 2/540

dokument, për t'i mundësuar një gruaje udhëtimin në ato shtete që nuk lejojnë hyrjen e tyre pa shoqërues familjar (mahrem), ose për ndonjë shkak tjetër.

Kjo gjë është tallje me ligjet fetare dhe nuk lejohet të bëhet e as t'i ndihmohet atij që e bën.¹⁰ E njëjta gjë vlen edhe për “shkurorëzimin formal”, i cili gjithashtu bëhet për shkaqe të ngjashme. Njoh personalisht njerëz që kanë bërë shkurorëzimin formal, me qëllim që të shfrytëzojnë ndihmën sociale nga shteti dhe lehtësimet shëndetësore. Këta i përkujtojmë: Kurora e një familje është më e shtrenjtë, sesa këto përfitime materiale. Ndërsa Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Si është puna me disa njerëz që luajnë me ligjet e Allahut dhe tallen me ajetet e Tij: të shkurorëzova, të ktheva, të shkurorëzova, të ktheva”*.¹¹

- Martesa pa pëlqimin e përgjegjës të gruas

Nëse një burrë dhe një grua kanë pasur lidhje jashtëmartesore dhe pastaj janë penduar dhe janë martuar pa pëlqimin e përgjegjës të gruas, ndërsa përgjegjësi tanimë nuk ka asgjë kundër kësaj martese, madje ka edhe raporte të mira me dhëndrin, themi se ata të dy duhet ta përsërisin shkurorëzimin, në atë formë sikurse e treguam më lart.

- Nëse babai refuzon dikë që ajo e do

Besimtari dhe besimtarja fillimisht duhet të kenë kujdes nga nëpërkëmbja e ligjeve të Allahut, të mos shikojnë burra/gra të huaja, të mos rrinë së bashku burra e gra, të mos lidhin kontakte në mënyrë të palejuar... Por nëse ndodh që një vajzë e shih një djalë dhe me shikim të parë dashurohet me atë, pastaj ai djalë vjen te përgjegjësi i kësaj për ta kërkuar këtë vajzë, por përgjegjësi refuzon, ai refuzim duhet respektuar. Lejohet që kjo vajzë të kërkojë metoda të ndryshme për ta bindur përgjegjësin e saj, por nëse sërish nuk pajtohet, ajo nuk ka të drejtë të martohet pa lejen e tij.

¹⁰ Islami, pyetje dhe përgjigje – Muhamed Salih el-Munexhid. (www.islamqa.net)

¹¹ Igathetul Lehfan, Ibën Kajjimi – hasen.

Por dashuria? Shumica e njerëzve me përvojë thonë se dashuria është ajo që lind pas martesës, pasi të kalojë një kohë më e gjatë. Ndërsa këto “dashuri” që paraqiten para se të bashkëjetojnë, ato nuk janë më shumë sesa pëlqim dhe mahnitje me pamjen e tij/asaj.

Sidoqoftë nëse për një vajzë kjo quhet fatkeqësi, i themi: Mos u mërzit, nuk është fatkeqësi e madhe, sepse fatkeqësia më e madhe është fatkeqësia në Fe, Allahu na ruajt të gjithëve. Besimtari e di se kjo botë është vend i sprovave dhe çdoherë që i përjeton sprovat faqebardhë, ai shpreson në shpërblimet e panumërta nga Allahu i Madhëruar. Kur vdiq Ebu Seleme, bashkëshorti i Umu Selemes, ajo u mërzit shumë, ndërsa i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, i mësoi asaj këtë lutje: *“O Zot më jep shpërblime nga kjo fatkeqësi (që më goditi) dhe ma zëvendëso me diçka më të mirë”*; ajo e bëri këtë lutje dhe tha: Si mund të ketë më të mirë se Ebu Seleme?! Por pas pak kohe në derën e saj trokiti Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, dhe e kërkoi për grua, dhe ajo pranoi. Kështu Allahu iu përgjigj lutjes së saj të sinqertë dhe këtë ia sugjerojmë çdo besimtari dhe besimtareje, që e ka goditur ndonjë fatkeqësi.

Literatura e konsultuar:

1. Muhamed b. Ismail esSan'ani, “Subulus salam el musile ila bulugil meram”
2. Abdullah Alu Bessam, “Teudihul Ahkam min bulugil meram”
3. Sejjid Sabik, “Fikhus sunne”
4. Muhamed b. Uthejmin, “Sherhul Mumtië ala Zail Musteknië”
5. “el-Fetava el-Xhamia lil mer’etil muslimë”
6. Ibën Tejmiye “Mexhmuatul Fetava”
7. Muhamed Salih Munexhid, “Islami, pyetje dhe përgjigje” (www.islamqa.net)
8. Grup autorësh, “Shpjegim i shkurtër i legjislaturës Islame” ■

AFTËSIA (MJESHTËRIA, ZOTËSIA)

Shumica e njerëzve harxhojnë shumë para për ushqim, për pije dhe për lukse të tjera, si për cigare, makina të shtrenjta dhe rroba ekstravagante, e nuk shpenzojnë asgjë për mendjen e tyre.

SHKRUAN: AGRON TERZIQI

Motori i anijes u prish, kapedani u përpoq me të gjitha mundësitë e tij që ta rregullojë, pastaj thirri ekspertët dhe mjeshtrit më të mëdhenj të rregullimit të motorëve, që kishte në anije, mirëpo të gjitha përpjekjet përfunduan me dështim. Pas disa ditësh orvatje kapedani ishte duke diskutuar me ndihmësit e tij rreth këtij problemi, papritmas i afrohet një person dhe i thotë: “Më vjen keq për shqetësimin, por e shoh se anija është e prishur që prej 10 ditësh, nga kureshtja e pyeta njërin nga punëtorët dhe më tha se është prishur motori i anijes, dhe se ka nevojë për t’u rregulluar... a ka ende nevojë që ta rregullojë dikush?” Pa hezituuar kapedani i tha po, përse pyet? Personi ia ktheu: “Me lejen e Zotit kam mundësi ta rregulloj.” Habia u shfaq në fytyrën e kapedanit për arsye se tek ai person nuk dukej asnjë shenjë që do të tregonte se është ndonjë ekspert anijesh. Kapedani e shoqëroi atë deri tek vendi i motorit dhe e la aty, ndërsa vetë u largua pak që të vështrojë se çfarë po bën. Personi nxori një çekiç të vogël dhe filloi ta qëllojë motorin me goditje të



lehta në të gjitha pjesët e tij, ai i shikonte dhe i prekte të gjitha pjesët kryesore të motorit, në fund e goditi atë në një vend të caktuar dhe shtrëngoi një bulon, i cili kishte lëvizur nga vendi i tij. Për çudi motori filloi të punojë, ndërsa kapedani i befasuar i gëzuar tej mase e pyeti: “Si arrite ta rregullosh?” Personi duke buzëqeshur ia ktheu: “Aftësia”. Ai i dha kapedanit një letër në të cilën shkruante 1000 dollarë. Kapedani e mori letrën dhe kur e shikoi shifrën e pyeti: “Njëmijë dollarë kundrejt një pune dhjetë minutëshe që bëre... të lutem ma sqaro pak këtë? Personi i tha me kënaqësi: “Një dollar kundrejt goditjes që i bëra motorit, ndërsa 999 dollarë për atë se

unë ia qëllova saktësisht vendit që duhej goditur në motor!!” Nga kjo mësojmë se si mjeshtëria e këtij personi i mundësoi atij që të fitojë 1000 dollarë për dhjetë minuta.

Prandaj sa më shumë të të shtohet dituria dhe kjo të bëhet e qartë tek njerëzit, ata më pas do të pyesin për opinionin tënd rreth problemeve të tyre, duke pritur prej teje këshilla për t'i zgjidhur ato.

Të mësuarit është një proces, i cili vazhdon gjatë gjithë jetës dhe përfundon vetëm me vdekjen tonë. Gjithmonë ka mundësi që për çdo ditë të mësojmë më tepër për të bërë një jetë më të rehatshme. Askush prej nesh nuk duhet ta humbasë rastin, nëse i jepet mundësia për të mësuar dhe për të përfutur diçka të re dhe të dobishme.

Dija është forcë, varësisht prej sasisë së diturisë që mund të zotërosh a do të jesh dijetar dhe do të kesh rast kështu që të bëhesh i suksesshëm dhe i lumtur... me dituri rritet shkalla e zgjuarsisë tënde dhe mendja jote hapet për horizonte dhe mundësi të reja.

Unë besoj fuqishëm se ne kemi mundësi që të mësojmë nga çdokush, prej çdo gjëje dhe në çdo kohë. Secili prej nesh që ka kryer shkollën fillore dhe atë të mesme, pasi i ka përfunduar ato ka menduar se ajo dije që ka nxënë atje është e mjaftueshme, pastaj kemi vazhduar për të mësuar në universitet dhe kemi menduar se kjo është shkalla më e lartë e diturisë që mund të arrihet. Mirëpo, në fund secili prej nesh është bindur se mësimi është proces i vazhdueshëm, i cili zgjat gjatë tërë jetës dhe se nuk përfundon sa jemi gjallë.

Ne kemi përfutur nga ligjet e natyrës, se kohëzgjatja e përhershme e një gjendjeje të mjerueshme është e pamundur, shpresa është gjithmonë ekzistuese me lindjen e diellit për një të nesërme më të mirë... kemi mësuar zellin, durimin dhe angazhimin prej bletës, e cila nuk pushon së punuari, ndërsa këmbënguljen nga milingona, secili prej nesh duhet të mbajë me vete një bllok shënimesh,

“Unë mendoj se ai person që di të lexoj dhe nuk e bën një gjë të tillë, nuk dallon me atë që është analfabet...”

që t'i shkruajë idetë e reja, të cilat na bëjnë dobi kudo që të jemi.

Sot në kohën tonë më shumë se në çdo kohë tjetër në të kaluarën ne zotërojmë mundësitë dhe mjetet, që të arrijmë dituri, të përparojmë dhe të shkojmë përpara... ku më kryesoret janë: ligjëratat shkencore, shkollat e natës, universitetet private, kurset e ndryshme në të gjitha lëmit.

Për të zotëruar ndonjë aftësi duhet ta luftojmë unin tonë, t'i rezistojmë qejfeve e epsheve tona dhe të punojmë me seriozitet. Ti ke mundësi që t'i përkushtohesh ndonjë fushe e ta përsosësh atë dhe pastaj të bëhesh referencë dhe udhërrëfyes për të tjerët. Zotërimi i ndonjë profesioni (mjeshtërie) është një vizion, i cili përbëhet nga qëllimi, forca, mundësia dhe distanca kohore. Ky vizion nuk ka kurrfarë vlere nëse nuk trupëzohet në një plan realizues, të arsyeshëm, të qartë dhe të saktë. Duke zotëruar profesionin në mënyrë të përsosur ne arrijmë të zbulojmë rolin që duhet ta kryejmë në këtë botë.

Ajo çka na jep shpresë është se pa i marrë parasysh se sa negative janë rrethanat jetësore, ambienti jo i përshtatshëm, apo trashëgimia e gjeneve është e keqe, mundësia për të përparuar dhe për t'u avancuar është e qartë.

Në bazë të një sondazhi të fundit mesatarisht shumica prej nesh harxhon në një vit diku rreth 400 orë duke drejtuar makinën. Në vend që të nervozohemi dhe të na kapi paniku nga kaosi që mbretëron në trafik, ne këtë kohë mund ta shfrytëzojmë në

mënyrë produktive. Secili prej nesh mund të mbajë në makinën e tij CD me ligjërata të dobishme me qëllim që të shtojmë njohuritë, apo kaseta me lexim Kurani dhe ta shfrytëzojmë këtë kohë duke i dëgjuar ato. Unë ju garantoj se nëse ndokush prej jush dëgjon 400 orë Kuran gjatë vitit, kur është duke vozitur makinën e tij me lehtësi do të mësojë përmendesh shumë kaptina të Kuranit.

Më lejoni t'ju bëj një pyetje, a keni dëshirë të lexoni? Besoj se shumica prej jush do të përgjigjeshit, po, natyrisht. Mirëpo, kush prej jush blen një libër e vendos më pas në raftin e bibliotekës së tij familjare dhe nuk e shfleton më kurrë për ta lexuar?!

Është bërë një studim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe është raportuar rezultati se adoleshentët i kalojnë diku rreth 39 orë në javë duke shikuar televizor, derisa të rriturit për shkak të angazhimeve diku rreth 30 orë në javë. Mirëpo, a thua si qëndron puna me vendet tona ku nuk kemi kesi lloj sondazhesh, këtë le ta llogarisë secili prej jush!

Kjo do të thotë se tek shumica shqetësimi kryesor është të ndjekë emisionet televizive, ku më pas ankohen dhe arsyetohen se nuk kanë kohë të mjaftueshme për të lexuar dhe nuk janë të suksesshëm në jetë. Po ta shfrytëzoje këtë kohë për të përsosur ndonjë zanat, mjeshtri apo art, do të ekzistonte mundësia që shumë shpejt të bëhesh i suksesshëm, i lumtur dhe i pasur. Për arsye se kudo që të punosh padroni nuk të paguan kundrejt kohës tënde, por ta paguan vlerën e kohës tënde, për këtë shkak te disa rroga e tyre arrin shumë gjashtë shifrore, por ka edhe të atillë që paguhen me një rrogë njëshifrore.

Shumica e njerëzve harxhojnë shumë para për ushqim, për pije dhe për lukse të tjera, si për cigare, makina të shtrenjta dhe rroba ekstravagante, e nuk shpenzojnë asgjë për

mendjen e tyre.

Duhet ta dimë se leximi për trurin është sikurse sporti për trupin. Leximi ndërton brenda nesh një personalitet të fortë. Unë mendoj se ai person që di të lexoj dhe nuk e bën një gjë të tillë, nuk dallon me atë që është analfabet. Këshilla ime është, mëso çdo gjë që lidhet me profesionin tënd që të bëhesh i shkëlqyer për çdo gjë që vepron. Ti duhet të paraqitesh në ligjërata, të shikosh programe arsimore, të dëgjosh kaseta me përmbajtje shkencore dhe të lexosh shumë, do ta vëresh shumë shpejt se do të të lindin ide të reja dhe do të kesh njohuri të shumta. Mëso, sa të kesh mundësi Kuran përmendsh, mëso ndonjë hadith, mëso gjuhë të huaj. Një intelektual duhet që mundësisht brenda muajit t'i lexojë pesë libra dhe t'i dëgjojë 10 ligjërata.

Thotë një urtak: "Qëndrimi para dritës së fenerëve me libër të hapur përpara, duke ndenjur me njerëz të brezave që nuk i ke takuar është kënaqësi që nuk mund të krahasohet me asgjë".

Të propozoj të vendosësh para vetes një objektiv, që të bëhesh i shkëlqyer në punën që kryen. Njerëzit e suksesshëm punojnë diku nga 10 deri në 12 orë në ditë. Ndërsa ti për të mbijetuar punon më së shumti 8 orë.

Bëje shprehi të zgjohesh gjysmë ore para kohe dhe shfrytëzoje këtë kohë për të shpikur mendime të reja, pastaj shënoje çdo mendim të ri dhe të dobishëm që të vjen në mend, në fund bëj një përmbledhje të këtyre ideve dhe fillo t'i praktikosh ato ide që të afrojnë me realizimin i ëndrrave të tua.

Çdo ditë bëja vetës këto pyetje: "Cila është ajo punë e dobishme të cilën mund të bëj sot dhe nuk e bëj?" pastaj, "Cila është ajo vepër që po ta kryeja në një mënyrë tjetër do të kishte rezultate më të mira?" pastaj, "Sot çfarë mund të veproj diçka që do ta shtonte imanin tim dhe do ta rrisë nivelin e jetës time?" ■

DETYRIMET E GRUAS NDAJ BURRIT

Në këtë numër do të flasim për detyrimet e gruas ndaj burrit. Këto detyrime nuk duhet të kuptohen si ngarkesë e tepërt e femrave, ose si cenim i të drejtave të tyre. Këto janë udhëzime dhe këshilla nga ana e Allahut

SHKRUAN: ZEKI ÇERKEZI

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, salat dhe selam mbi atë pas të cilit nuk ka të dërguar tjetër, mbi familjen e tij të pastër, mbi shokët e tij dhe të gjithë ata që e pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Allahu Fuqiplotë krahas krijimit të njerëzve ka caktuar ligje dhe rregulla, të cilat janë në përshtatje për njeriun dhe i përshtaten aftësive psiko-fizike të tij. Një pjesë të këtyre ligjeve, ligjet kosmologjike, i imponohen njeriut pa vullnetin e tij, por assesi në dëm të tij, përkundrazi. Kurse një pjesë tjetër e këtyre ligjeve, urdhëresave e ndalesave, këshillat dhe udhëzimet e Allahut, njeriut nuk i imponohen. Këto ligje njeriu nëse dëshiron i pranon, e nëse jo – i refuzon. Por si pranimi, ashtu edhe refuzimi i këtyre ligjeve dhe rregullave, nuk mbesin pa pasoja, qofshin të mira apo të këqija.

Disa prej këtyre ligjeve i trajtojnë edhe raportet bashkëshortore. Në këtë numër do të flasim për detyrimet e gruas ndaj burrit. Këto detyrime nuk duhet të kuptohen si ngarkesë e tepërt e femrave, ose si cenim i të drejtave të tyre. Këto janë udhëzime dhe këshilla nga ana e Allahut, që të mbretërojë harmonia e mirëfilltë familjare, e cila është edhe parakushti elementar për mirëqenien e mbarë shoqërisë. Përndryshe, nëse kundërshtohen këto rregulla, atëherë ndodh

ajo që po ndodh në shumë vende të botës – shkatërrimi i institucionit të familjes.

Allahu i Lartmadhëruar thotë: ***“Kështu, gratë e drejta janë të bindura me çiltërsi (ndaj Allahut dhe ndaj burrave të tyre) dhe ruajnë në mungesë të bashkëshortëve të tyre, atë që Allahu i ka urdhëruar ato të ruajnë (dëlirësinë, ndershmërinë e tyre, pasurinë e bashkëshortëve të tyre e tjerë)”***. (përkthimi i kuptimit Kurani 4: 34), pra, gruaja **saliha** – e mirë, e drejtë – është ajo që kujdeset gjithmonë për ato gjëra, për të cilat Allahu e ka detyruar. Me fjalë të tjera, ajo ruan



sekretet e burrit, gjegjësisht i nuk i zbulon sekretet e dhomës së fjetjes, sekretet e shtëpisë. Një grua e tillë është shumë më e mirë, se sa një grua, e cila s'është *salih*, po edhe qoftë më e bukur.

Do të mundohemi të përmendim këtu disa detyrime të gruas ndaj burrit:

Detyrimi i parë: gruaja besimtare nuk ka të drejtë ta refuzojë thirrjen e burrit për në shtrat, sepse i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, në një hadith të saktë të përcjellë nga Buhariu dhe Muslimi, ka thënë: *“Nëse burri e thërret gruan e tij në shtrat, e ajo e refuzon dhe ai e kalon natën i zemëruar në te, melaiket do ta mallkojnë atë grua deri në mëngjes”*. Në një tjetër transmetim nga Muslimi në Sahihun e tij, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk ndodh që një burrë ta thërrasë gruan e tij në shtrat e ajo e refuzon, veçse Ai i cili është përmbi qiejt është i hidhëruar me atë grua, derisa ai (burri) të jetë i kënaqur me gruan e tij”*. Pra, këto dy hadithe tregojnë qartë peshën e madhe të kësaj çështje. Ndërsa në hadithin e parë përmendet se ajo mban mbi vete mallkimin e melaikëve, në hadithin e dytë ajo kërcënohet me diçka akoma më të rëndë, me zemërimin e Allahut.

Detyrimi i dytë: gruaja besimtare nuk ka të drejtë të agjërojë pa lejen e burrit. Kuptohet, këtu bëhet fjalë për agjërim vullnetar. Kjo është një prej të drejtave të burrit te gruaja e tij. Buhariu dhe Muslimi në Sahihat e tyre përcjellin nga Ebu Hurejre se i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Nuk i lejohet gruas të agjërojë në praninë e burrit, përveçse me lejen e tij. Gjithashtu, nuk i lejohet gruas ta pranojë dikë të hyjë në shtëpi, veçse me lejen e tij”*. Nga hadithi kuptohet se fjala bëhet për agjërim nëse burri nuk është në rrugë. Por nëse bëhet fjalë për agjërim të detyrueshëm, atëherë nuk kërkohet leje. Si për shembull, nëse prej

“Femra që i fal të pesë kohët e saj, e agjëron muajin e saj (Ramazanin), e ruan moralin e saj dhe e ka kënaqësinë e burrit, do të hyjë në xhenet”..”

muajit Shaban kanë mbetur aq ditë sa i mjaftojnë asaj për kompensimin e ditëve të paagjëruara të Ramazanit, atëherë ajo agjëron pa lejen e burrit. Kuptohet se një çift i devotshëm, as që paramendohet të kenë probleme të këtij lloji, por këto rregulla po i përmendim që gjithkush t'i dijë të drejtat dhe detyrimet e veta.

Nga hadithi i përmendur më lart, mësojmë edhe detyrimin e tretë të gruas, e ai detyrim është që gruaja nuk ka të drejtë ta pranojë dikë në shtëpi pa lejen e burrit, duke u bazuar në fjalët e të Dërguarit salallahu alejhi ue selem: *“...nuk i lejohet gruas ta pranojë dikë në shtëpi pa lejen e burrit”*. (Buhariu dhe Muslimi). Dhënia e lejes nga ana e burrit është në dy forma:

leja e nënkuptuar nga tradita e vendit. Nuk ka nevojë që të kërkohet leje gojarisht. Si për shembull, dihet se burri nuk e ndalon hyrjen në shtëpi të afërmve të burrit nga gjinia femërore, të afërmve të gruas, të fqinjës, shoqet e gruas, e të ngjashme. Pra, i lejohet gruas t'i pranojë këto femra në shtëpi pa kërkuar leje të veçantë, me përjashtim nëse burri e veçon ndonjërin prej këtyre femrave, duke thënë: filanen mos e prano në shtëpi. Në këtë rast gruaja është e detyruar ta respektojë këtë urdhër të burrit.

Leja gojore e përgjithshme, ku në këtë rast burri i thotë gruas: e ke lejen time të pranosh kë të duash, me përjashtim nëse vëren ndonjë

të keqe prej ndonjëres. Nga ky hadith, si dhe nga ajete dhe hadithe të tjera, nënkuptohet se burri është zot shtëpie, ai kontrollon me kujdes të veçantë çdo hyrje-dalje në shtëpi. Jo se ai sillet si diktator në shtëpi, jo se nuk i beson gruas, por për shkak se Allahu e ka detyruar, si burrin ashtu edhe gruan, që mos të hyjë në shtëpitë e besimtarëve një person, i cili ua dobëson imanin anëtarëve të familjes. Kushdo që të jetë ai, sado i afërm i gruas, ose i burrit të jetë ai njeri, sepse ka femra, sidomos sot, të cilat mundohen të përhapin rebelim ndaj urdhrave të Allahut. Këta njerëz frymëzohen nga shejtani i mallkuar, çka vërtetohet me fjalët e Allahut në Kuran: ***“Dhe kësajsoj Ne kemi caktuar për çdo Pejgamber armiq – shejtanët nga njerëzit dhe xhinët, duke e frymëzuar njëri-tjetrin me fjalë të stolisura për mashtrim.”*** (Kurani 6: 112), si dhe në ajetin tjetër: ***“Përkujto ditën kur Ai i tubon ata të gjithë (e u thotë): “O grumbull i xhinëve, ju mashtruat shumë njerëz! “E nga njerëzit që ishin miq të tyre (të xhinëve)...”*** (Kurani 6 : 128). Ka edhe shumë ajete të tjera, të cilat vërtetojnë se ky koalicion i shejtanëve, nga gjinia njerëzore dhe nga bota e xhinëve përpiqen gjithmonë dhe inspirohen reciprokisht, që të përhapin amoralitet dhe punë të liga. Jo rrallë dëgjon fjalë të tilla si: filan grua u thotë të tjerave: pse po falesh? Ose iu thotë: A je mbuluar!? Hiqe shaminë, kjo është prapambeturi. Pra, besimtari dhe besimtarja nuk duhet të shoqërohen me këta njerëz, aq më tepër kur burri e ndalon që një femër e tillë të hyjë në shtëpinë e tij. Na përcillet se Abdullah b. Mesudi një ditë, kur është kthyer në shtëpi vëren një hajmali, e cila s’ka qenë aty në çastin kur ka dalë nga shtëpia. Ai e pyet menjëherë gruan se ç’është ajo hajmali? Ajo i tregon se e ka prurë atë një grua fqinje, e cila ka qenë aty për vizitë. Ibën Mesudi e shkatërron menjëherë atë hajmali dhe ia ndalon gruas që ta pranojë atë fqinje në shtëpinë e vet. Nga ky rast i këtij sahabiu të

madh, i cili ka qenë njëkohësisht edhe dijetar i madh, ne mësojmë se si duhet të veprojë besimtari në raste të tilla, i cili ia ndaloj bashkëshortes shoqërimin me atë grua.

Detyrimi i katërt: kujdesi i gruas për edukimin e fëmijëve. Këtu nënkuptohet mësimi i fëmijëve për gjërat më elementare të detyruara nga Kurani dhe Suneti, varësisht edhe nga mosha e fëmijës. Përveç kësaj gruaja është përgjegjëse edhe për pastërtinë e fëmijëve, veshmbathjes së tyre, si dhe të tërë shtëpisë. Kujdeset edhe për shëndetin e fëmijëve, çka nënkuptohet nga fjalët e të Dërguarit salallahu alejhi ue selem: ***“...dhe gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit dhe kujdeset për fëmijët. Të gjithë ju jeni barinj dhe secili do të japë llogari për tufën e tij”***. (Buhariu dhe Muslimi)

Detyrimi i pestë: gruaja kujdeset për ekonominë shtëpiake. Ajo nuk shpenzon tepër dhe pa nevojë. Nuk bënë harxhime të panevojshme në haje dhe pije, në veshmbathje dhe në gjëra të tjera shtëpiake.

Këto ishin disa pika, të cilat menduam se është e nevojshme të përmenden, çka nuk do të thotë se nuk ka edhe detyrime të tjera. Ajo është përgjegjëse para Allahut, e pastaj edhe para burrit. Për këto gjëra do të pyetet nga ana e Allahut. Nëse i kryen këto detyrime me besnikëri dhe me përgjegjësi, padyshim se do ta ketë kënaqësinë e burrit, çka është garanci se do ta fitojë xhenetin, sepse i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, ka thënë: ***“Femra që i fal të pesë kohët e saj, e agjëron muajin e saj (Ramazanin), e ruan moralin e saj dhe e ka kënaqësinë e burrit, do të hyjë në xhenet”***.

E lusim Allahun Fuqiplotë të na i bëjë familjet tona të devotshme, ku mbretëron atmosfera islame. Salati dhe selami qofshin mbi të Dërguarin, mbi familjen e tij dhe shokët e tij, dhe lutja jonë e fundit është: gjitha falënderimet dhe lavdërimet janë për Allahun, Zotin e të gjithë botëve. ■

PESË VEÇORI PËR TA SHTUAR BUKURINË E VËRTETË

MUS'AB B. ABDULAZIZ EL-MURSHID

Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe mëshira qofshin mbi prijësin e të dërguarve Muhamedin.

Ti je bukuroshe!! Po bukuroshe... Do të pyesësh, prej nga e kuptove këtë gjë? Që ta kuptosh përgjigjen hape zemrën për fjalët e mia, përfundoje leximin dhe e lus Allahun që t'i hapi ty dyert e xhenetit e ta shtojë bukurinë...

Mirëpo, oj e bukur, prej cilave bukuroshe je ti? A je e bukura, e cila respekton Krijuesin me bukurinë e saj?!... E ruan bukurinë nga çdo mëkat, bën durim nga sprovat dhe mashtrimet, e falënderon Allahun për këtë dhunti, atëherë Allahu të mundëson të jetosh një jetë me gazmend, të cilën ta zëvendëson me xhenete dhe kështjella... Vlera e kësaj bukurie do të jetë gëzim i përhershëm e jetë e qetë, ndërsa shpërblimi i ahiretit është edhe më i madh, është mall i shtrenjtë, të cilin Allahu çdo ditë e zbukuron, *në të ka atë çfarë syri nuk e ka parë, as veshi s'e ka dëgjuar, e as që mendja e paramendon*, myzhde për atë, Allahu ia bëftë fytyrën e bardhë atë ditë kur do t'i zbardhen fytyrat disave dhe disave do t'u nxihen. Allahu thotë: *"Ndërsa atyre që fytyrat e tyre u janë zbardhur, ata janë në*

Oj muslimane, mbulesa të mbron ty nga shikimet helmuese që burojnë nga zemrat e sëmura dhe njerëzit e poshtër, pra, përmbaju mbulesës. Mos i vëre thirrjet tendencioze, të cilat e luftojnë mbulesën dhe mundohen ta zhvlerësojnë atë

mëshirën (xhenetin) *e Allahut dhe aty janë përgjithmonë.*" Ali Imran, 107.

Apo je bukuroshe, e cila ballafaqohet me Krijuesin e saj me mëkatë?! I shfaq mëkatet çdo të afërmi dhe çdo të largëti, je e pranishme aty ku Allahu ndalon, mungon aty ku Allahu është i kënaqur, si shpërblim për atë bukurë do të ketë një jetë të vështirë në këtë botë, ndërsa në ahiret të pret zjarri dhe prangat, sa përfundim i keq, sa herë që do të digjet ajo lëkurë e bukur ka për t'u ndërruar me një lëkurë tjetër për ta shijuar dënimin e Allahut *"Sa herë që u digjen lëkurat e tyre, Ne iu ndërrojmë lëkura të tjera që të shijojnë dënimin. Allahu është i plotëfuqishëm, i drejtë.*" Nisa, 56.

Përsërite dhe pyete veten, me zë të lartë, prej cilave bukuroshe jam unë? Pasi ta dëgjosh përgjigjen prej vetes tënde, më lejo mua që të dhuroj disa veçori për ta shtuar bukurinë, i kam përmbledhur për ty nga fjalët e dijetarëve dhe ta dish se nuk të shëndoshin ato, por vetëm nëse praktikohen, me bekimin e Allahut, e ty të mbetet fitimi, ndërsa mua borxhi.

Veçoria e parë:

Motra ime, mbulesa ia shton besimtares bukurinë dhe e mbron trupin nga Zjarri, i cili flakëron, e ruan me lejen e Allahut trupin tënd nga shikimet helmuese dhe i jep përshtypjet e duhura atij që dëshiron rehati shpirtërore. Dijetari Salih El-Feuzan thotë: “Mbulesa do të thotë që gruaja ta mbulojë trupin e saj nga burrat të cilët nuk janë prej atyre që i ndalohet të martohet (mahrem), siç thotë Allahu: **“Të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të venë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, babait të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet.”** Nur, 31. Argument nga Suneti i të Dërguarit, salAllahu alejhi ue selem, për detyrimin e mbulimit të fytyrës së gruas nga burrat me përjashtim të atyre që i ka mahrem është hadithi që na e përcjell Ajsha, radijallahu anha, e cila thotë: **“Kalonin pranë nesh kalorësit, e ne ishim me të Dërguarin, salAllahu alejhi ue selem, të nisur për në Mekë, nëse ecnin paralel me ne një prej nesh e hidhte rrobën e saj nga koka mbi fytyrë, e kur kalonin ata, ne i zbulonim fytyrat.”** E përcjell: Ahmedi, Ebu Davudi dhe Ibën Maxhe. Dije, oj motër muslimane, se edhe ata që lejuan zbulimin e fytyrës prej dijetarëve, mendimi i të cilëve ka peshën e vet, e përcaktuan atë vetëm në rast të sigurisë nga fitneja, por fitneja, sidomos në kohën e sotme nuk është e sigurt. Sot është pakësuar përmbajtja fetare tek burrat e tek gratë, u pakësua turpi dhe u shtuan thirrësit e fitnes, u ndryshuan gratë me vendosjen e gjërave zbukuruese në fytyrat e tyre, gjë e cila çon në fitne, kështu që ki kujdes nga kjo oj motër muslimane dhe mbaje mbulesën mbrojtëse me lejen e Allahut për sprovat. Nuk ka asnjë nga dijetarët e hershëm e as nga bashkëkohorët t’ia bëjnë të lejuar këtyre grave provokuese atë gjendje në të cilën kanë rënë. Oj muslimane, mbulesa të mbron ty nga

shikimet helmuese që burojnë nga zemrat e sëmura dhe njerëzit e poshtër, pra, përmbaju mbulesës. Mos i vëre thirrjet tendencioze, të cilat e luftojnë mbulesën dhe mundohen ta zhvlerësojnë atë, këta njerëz të dëshirojnë vetëm të keqen, thotë Allahu i Madhëruar: **“E ata që ndjekin dëshirat e epsheve, dëshirojnë që ju të shmangeni në tërësi** (nga rruga e drejtë).” Nisa, 27. Për t’u kompletuar kjo veçori lexoje me vëmendje fjalën e dijetarit të famshëm musliman Muhamed b. Salih El-Uthejmin, Allahu e mëshiroftë, për kushtet e mbulesës në Islam:

-Të jetë mbulesa e mjaftueshme për ta mbuluar gjithë atë që e ka detyruar Allahu prej trupit, fytyrës dhe duarve.

-Të mos jetë mbulesa e zbukuruar, sikurse e mbulon ndokush kokën e saj me shami provokuese e të zbukuruar, të stolisur e të lidhur në atë formë që i tërheq shikimet.

-Të jetë e gjerë e të mos jetë e ngushtë e të duket trupi.

-Të mos jetë e tejdukshme, por të jetë e trashë.

-Të mos jetë e tymosur me temjan apo e parfumuar.

-Të mos i përngjajë veshjeve të mosbesimtareve.

-Të mos i përngjajë veshjeve të burrave.

-Të mos jetë veshje për famë.

Veçoria e dytë:

Kjo veçori është e veçantë për sytë magjepsës, kush vepron ndryshe kësaj veçorie ka rënë në të njëjtin nivel me ato që e ndërrojnë fizionominë që ua ka krijuar Allahu, i ka ofruar vetes dëbimin dhe largimin nga mëshira e Allahut të Madhëruar.

Dijetari Muhamed b. Uthejmin, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Dispozita fetare për shkuljen e vetullave është se kjo gjë numërohet prej mëkateve të mëdha, sepse për këtë vepër është vërtetuar nga i Dërguari,

salAllahu alejhi ue selem, se e ka mallkuar atë femër që i shkël vetullat dhe atë që i shkël vetullat, gjë e cila aludon në fetarizmin e dobët, dobësimin e mendjes gjithashtu, përndryshe kush do të ishte dobia për t'i shkëlur qimet e vetullave e më pas në atë vend vendos një vijë të zezë për ta njollosur fytyrën e saj.

Veçoria e tretë:

Motra ime e bukur, na përcjell Buhariu nga Abdullah b. Mesudi, radijallahu anhu, se i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Allahu e ka mallkuar atë grua që i lidh (shton) ndonjë gruaje flokë dhe asaj gruaje që i lidhen (shtohen) flokë, atë që bën tatuazhe dhe atë që i bëhet tatuazhi, atë që i shkël vetullat dhe asaj që i shkël vetullat dhe ato që i gdhendin dhëmbët për zbukurim, ato që ndryshojnë fizionominë që ua ka krijuar Allahu.”*

Dijetari Salih El-Feuzan në komentin e këtij hadithi thotë: “I ndalohej besimtares që t'i gdhendë dhëmbët e saj për zbukurim, duke i punuar me limë e të bëjë zbrazëtira ndërmjet dhëmbëve, duke dëshiruar të zbukurohet, por nëse në dhëmbët e saj ka deformim dhe i lind nevoja për përpunim, me qëllim për t'i drejtuar dhe për ta larguar deformimin apo ka karies dhe duhet të rregullohet për ta larguar kariesin nuk prish punë, kjo ka të bëjë me mjekimin dhe largimin e deformimit, dhe këtë gjë e bën një mjeke e specializuar.

Gjithashtu ky dijetar në komentimin e hadithit të mëparshëm na thotë: “Gruas i ndalohej tatuazhi në trupin e saj, sepse i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, e ka mallkuar atë që bën tatuazhe dhe atë që i bëhet tatuazhi. Tatuazh është ajo që shpohet në dorë apo në fytyrë me anë të gjilpërës pastaj e mbush atë vend me ngjyrë të zezë dhe ngjyra të tjera, kjo vepër është e ndaluar dhe është prej mëkateve të mëdha, sepse i

“Oj motër, ti tani je në vendin e punës, e nesër do të jetë Dita e Llogarisë e nuk do të ketë punë, pra, a je e përgatitur për Ditën e Llogarisë?...”

Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, e ka mallkuar atë që e vepron këtë gjë, e mallkimi bëhet vetëm ndaj mëkateve të mëdha.

Veçoria e katërt:

Motra ime, veshja është pasqyrim i bukurisë tënde, ajo është mënyra që të çon në xhenet gjerësia e të cilit është sa qiejt e toka, apo në zjarr që fundin e ka të thellë. Ki kujdes, oj motër, dhe medito rreth thënies së të Dërguarit, salAllahu alejhi ue selem, që e përcjell Ebu Hurejra, radijallahu anhu: *“Dy lloj njerëzish janë nga banorët e zjarrit, unë nuk do të arrij t'i shoh: Gra të veshura, por duken si të zhveshura, ecin duke u dredhuar, kokat do t'i kenë si shpinat e ngritura të deveve, nuk do të hynë në xhenet e as që do ta ndiejnë erën e tij. Burra që do të kenë kamxhikë si bishtat e lopëve dhe me to do t'i rrahin njerëzit.”* Përcjell Muslimi.

Shejhul Islam Ibën Tejmije në librin e tij “Mexhmu'ul Fetava” (22/144), në komentin e hadithit: *“të veshura, por duken si të zhveshura”* thotë: sepse ato veshin rroba, që nuk ua mbulojnë trupin, ajo është e veshur mirëpo në të vërtetë është e zhveshur, si për shembull, ajo që vesh rrobë të tejdukshme, që ia përshkruan trupin e saj, apo rroba, e cila shfaq pjesët e trupit të saj. Veshje e gruas është ajo që e mbulon trupin dhe gjymtyrët e saj, kur mbulesa është e trashë dhe e gjerë. Përfundon kështu thënia e tij.

Allahu të bekoftë oj motër, një copë pëlhere bëhet shkak për hyrjen tënde në Zjarr dhe a është mençuri që për një copë pëlhere ta shesësh vendin tënd në xhenet?.

Veçoria e pestë:

Çdo të thotë bukuri?

Kush është e bukura?

A jam unë e bukur?

Pyetje që i lë pa gjumë bukuroshet dhe i huton mendjet e vajzave. U ngatërruan peshoret, u çrregulluan faktet për zgjidhjen e saj, mirëpo bukuroshja besimtare, nëse gjykon me mendjen e saj atëherë do të udhëzohet drejt përgjigjes, e do të kuptojë të vërtetën.

A është bukuroshe ajo që barazon mes bukurisë së trupit dhe bukurisë së moralit, fesë dhe shpirtit të saj? Po, oj motër kjo është bukuroshja e vërtetë, sepse bukuria e trupit në vetvete mund të jetë e mjeruar. Sa e sa vajza të bukura nuk e dëshirojnë shoqërinë me njerëzit, bile dhe nuk dëshirojnë t'i njohin, sepse ata shohin se këto vajza janë të pavlera me këtë bukuri. Sa raste kemi dëgjuar se shkak i divorceve dhe i shkatërrimit të shtëpisë së saj është bukuria, po bukuria. Ky është realiteti i dhuntive, nëse nuk e falënderojmë Allahun për to, e i bëjmë mëkat Allahut e kështu kjo gjë shndërrohet në mëri dhe dënim nga Allahu i Madhëruar.

Shkurtimisht i themi vajzës së bukur besimtare e të moralshme: përkujdesu për bukurinë e trupit, ngase Allahu është i bukur dhe e do bukurinë, mirëpo mos e lë pas dore bukurinë e shpirtit, të fesë dhe moralit, për ta shtuar bukurinë e elegancën e të bëhesh vajzë me të gjitha veçoritë.

Ta dish se bukuria është relative dhe nuk mund ta matësh, e as t'i kaktosh kufij. Për atë që është injorant mund të gjykojë ndaj çdo vajze në përgjithësi, se është e shëmtuar. Mos harro se bukuria e fizionomisë së jashtme humbet e mbetet bukuria fetare e morale.

Në fund themi:

Oj motër, duhet ta dish se bukuria është në atë që e ka lejuar Allahu, e mos u brengos. Në qoftë se ke mangësi në raportet me Allahun, përkushtoju pendimit që tani, ***“Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”*** Nur, 31.

Përkujto atë ditë kur do të qëndrosh para Sunduesit e Mbizotëruesit ***“Ditën kur çdo njeri e gjen pranë vetes atë që veproi mirë ose keq, e për atë të keqe që bëri, do të dëshirojë që në mes tij dhe në mes të asaj të ketë një distancë shumë të madhe*** (e mos ta shohë). ***Allahu u jep të frikësohen prej dënimit që vjen prej Tij, megjithëqë Allahu është i mëshirshëm ndaj robërve.”*** Ali Imran, 30. Përkujto kur do të thotë kundërshtuesi e mëkatari: ***“O i mjeri unë që kam lënë mangut respektimin ndaj Allahut dhe që kam qenë prej atyre që talleshin!”*** Zumer, 56.

Përkujto si do të jetë gjendja jote kur do të vijë shkatërruesi i kënaqësive (vdekja), ndërsa ti vazhdon duke i bërë mëkat Allahut, e ta merr shpirtin, e atëherë do të thuash ***“E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që lëshova!” Kurrsesi, kthim nuk ka e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde*** (distancë periodike) ***deri në ditën kur do të ringjallen.”*** Muminun, 99-100

Oj motër, ti tani je në vendin e punës, e nesër do të jetë Dita e Llogarisë e nuk do të ketë punë, pra, a je e përgatitur për Ditën e Llogarisë?

E lus Allahun e Lartësuar të na e pranojë pendimin tonë, na pastro mëkatet, na furnizo me dituri të dobishme dhe vepra të singerta, Ai është Mbikëqyrës dhe i Plotfuqishëm për çdo gjë, paqja dhe mëshira e Allahu qofshin mbi të Dërguarin tonë Muhamedin. ■

Përktheu: Shpend ZENELI

SI TË JESH BAMIRËS NDAJ PRINDËRVE...

1- Follu atyre me kulturë dhe fjalë të mira dhe mos u bëj i ashpër me to e as mos u thuaj "of".

2- Respektoji ata përderisa nuk të shpijnë në mëkat ndaj Allahut, sepse nuk respektohet krijesa kur i bën mëkat Krijuesit.

3- Bëhu i butë me ata dhe mos ua kthe ftyrën duke u hidhëruar.

4- Ruaje nderin dhe pasurinë e tyre dhe mos merr gjë nga pasuria pa leje.

5- Vepro diçka që i gëzon ata ndonjëherë edhe pa lejen e tyre, duke u blerë diçka apo të ngjashme për dhuratë.

6- Konsultohu me ta për punët tuaja. E nëse detyrohesh ndonjëherë që mos të biesh dakord me ta, atëherë kërko ndjesë prej tyre.

7- Përgjigju ftesës së tyre me buzëqeshje dhe shpejtësi duke u thënë: Urdhëro baba ose urdhëro nënë, sepse edhe Ibrahim i alejhi selam i thoshte babait të tij: O babai im!- edhe pse ai ishte jobesimtar.

8- Ndero farefisin dhe shokët e tyre, qofshin të gjallë apo pas vdekjes.

9- Kur nuk pajtohesh me to mos polemizoj shumë, por mundohu që t'ua sqarosh të vërtetën me kulturë.

10- Mos u bëj kokëfortë e as mos e ngri zërin para tyre. Fol me zë të ulët dhe me kulturë.

11- Ngrihu kur të hyjnë tek ti dhe puthua kokën atyre siç vepronte Fatimeja

radijallahu anha me Resulullahun salallahu alejhi ue selem.

12- Ndihmoje nënën në shtëpi dhe mos ngurro ta ndihmosh babanë në punë.

13- Mos udhëto pa lejen e tyre, e nëse detyrohesh që të udhëtosh, atëherë kërko ndjesë prej tyre.

14- Mos u fut tek ata pa leje, sidomos kur janë duke fjetur.

15- Nëse e pi duhanin, mos e pi para tyre, por më e mira është që të largohesh nga pirja e duhanit.

16- Mos fillo të marrësh ushqim para tyre në tryezë.

17- Mos i gënje ata, nëse nuk të pëlqen ndonjë veprim apo sjellje e tyre mos i fajëso ata.

18- Mos i jep përparësi gruas dhe fëmijëve para tyre. Kërko pëlqimin e tyre në çdo punë. Muhamedi salallahu alejhi ue selem, thotë: *"Pajtimi i Allahut është te pajtimi i prindërve, kurse zemërimi i Allahut është te zemërimi i prindërve"*.

19- Mos u ul më lartë se ata dhe mos i shtri këmbët para tyre nga mendja e madhe.

20- Nëse je me pozitë mos u lavdëro para prindërve për pozitën që ke.

21- Mos u bëj koprrac ndaj tyre, por shërbeju, sepse ajo do të kthehet nga fëmijët e tu.

22- Shpeshtoi vizitat tek ata, duke iu dërguar dhurata.

23- Në radhë të parë ta respektosh nënën



pastaj babanë dhe ta dish se xheneti është në respektin e nënës.

24- Nëse nuk i dëgjon dhe i zemëron ata, do ta kesh jetën të vështirë në këtë botë dhe në atë botë dhe do të kthehet njësoj nga fëmijët e tu.

25- Mos kërko shumë prej tyre, kur të kërkosh dhe ata të japin falënderoji ata, por nëse nuk të japin kërkoju ndjesë.

26- Kur të rritesh dhe ke mundësi të punosh për ta fituar rizkun ndihmoje babanë.

27- Ti me të vërtetë ke detyra ndaj prindërve, por ke detyra edhe ndaj gruas dhe secilit jepi të drejtën e vet.

28- E nëse vjen ndonjëherë deri tek acarimi mes prindërve dhe gruas, atëherë bëhu i mençur dhe zgjidhe problemin me mençuri.

29- Nëse bie në kundërshtim me ta për kurorëzim apo shkuroorëzim, atëherë gjyko

me ligjet e sheriatit, se kjo është forma më e mirë e gjykimit.

30- Lutja e tyre pranohet qoftë për mirë apo për keq. Ki kujdes që mos të luten ndaj teje për keq.

31- Të jesh i kujdesshëm me njerëzit, që mos t'i shash, sepse edhe ata të shajnë. Muhamedi salallahu alejhi ue selem thotë: *“Prej mëkateve të mëdha është që njeriu t'i ofendojë prindërit e tij. I thanë: Ja Resulallah, si mundet që njeriu t'i ofendojë prindërit e vet. Ai tha: I shan babën ndokujt e ai të shan babën ty. I shan nënën ndokujt e ai ta shan ty”*.

32- Vizitoji ata duke qenë të gjallë. E pas vdekjes jep sadaka për ata dhe lutu për ta duke thënë: O Zot më fal mua dhe prindërit e mi. O Zot, mëshiroji ata sikurse më kanë edukuar mua kur isha fëmijë. ■

Zgjedhi dhe përktheu: Enver AZIZI

KOMENTI DHE VLERA E AJETUL KURSISË

SHKRUAN: BASHKIM BAJRAMI

“ALLAHU LA ILAHE ILA HU. EL-HAJJUL KAJJUM. LA TE’HUDHUHU SINETUN UE LA NEUM. LEHU MA FIS-SEMAVATI UE MA FIL-ERD. MEN DHELEDHI JESHFEU INDEHU, IL’LA BI IDHINIHI. JAËLEMU MA BEJNE EJDIHIM UE MA HALFEHUM, UE LA JUHITUNE BI SHEJ’IN MIN ILMIHI IL’LA BI MA SHAE. VESIA KURSIJJUHUS-SEMAVATI UEL ERDA, UE LA JEUDUHU HIFDHUHUMA UE HUVEL ALIJJUL ADHIM.”

“Allahu. Askush nuk meriton të adhurohet përveç Tij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm (i Gjalli, Vigjiluesi). Atë nuk e kap as kotja, as gjumi. Gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pos me lejen e Tij? Ai e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që Ai di të tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursija e Tij përfshin qiejt dhe tokën dhe kujdesi i Tij ndaj të dyjave nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi.”

Ky është Ajetul-Kursij, një ajet që ka rëndësi shumë të madhe. Në një hadith të saktë i Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ue selem, për këtë ajet ka thënë se është ajeti më i vlefshëm në librin e Allahut. Imam Ahmedi përcjell nga Ubej b. Ka’bi, se i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, e ka


pyetur atë: “*Cili është ajeti më i madh në librin e Allahut?*” Ai i tha: *Këtë e di më mirë Allahu dhe i Dërguari i Tij.* I Dërguari salaAllahu alejhi ue selem e përsëriti këtë disa herë, pastaj Ubeji i tha: *Ajetul-Kursij.* Pejgamberi salaAllahu alejhi ue selem i tha “*O Ebu Mundhir të uroj ty për dijen tënde. Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, ky ajet ka gjuhë dhe dy buzë, që e shenjtërojnë Sunduesin te froni, Arshi.*” E përcjell Muslimi.

Dhe për t’iu përgjigjur kësaj pyetje duhet një shikim, meditim dhe studim i thellë i Kuranit Famëllartë që përmban mijëra ajete, nëse dëshiron dikush të gjykojë se ky është ajeti më i madh në librin e Allahut i nevojitet të jetë i pranishëm në komentimin e të gjitha ajeteve dhe pastaj ka mundësi të gjykojë, se me të vërtetë ky është ajeti më i madh në Kuranin Fisnik.

Emri më i madh i Allahut është në Ajetul-Kursij

Imam Ahmedi përcjell nga Esma binti Jezid se ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, të thotë: Në këto dy ajete: “***Askush nuk meriton të adhurohet, përveç Tij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm*** (i Gjalli, Vigjiluesi)...”, dhe

“***Elif, Lamë, Mimë. Allahu është Ai i vetmi që nuk meriton të adhurohet, përveç Tij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm***”, gjendet emri më i madh i Allahut. E përcjell



Tirmidhiu (hasen-sahih).

Ky ajet ka dhjetë fjali. Secila prej tyre ka një domethënie madhështore. Allahu ka thënë (në fillim):

Allahu Fjala Allah, është e veçantë për genien më të lartë, domethënë emër i veçantë për vetë Allahun, të plotfuqishmin e të madhërishmin. Ky emër s'është i zbatueshëm për tjetërkënd veç Allahut, qoftë në kohët e periudhës para-islamike (injurancës), qoftë në kohën e Islamit, sepse Allahu është Rabbul-Alemini (Zoti i të gjithë botëve), i Plotfuqishmi e Madhështori.

1-Allahu. La ilahe il'la Hue" është 'la ilahe il'la Hue/askush nuk meriton të adhurohet, përveç Tij'.

Ilah do të thotë me'luuh, apo ai që adhurohet nga dashuria dhe respekti. Asgjë nuk e meriton këtë cilësi, përveç Allahut, Atij që është i pastër nga çdo e metë. Të gjithë "zotat" krahas Allahut, të cilët adhurohen në tokë apo në qiej, si p.sh.

engjëjt, nuk meritojnë të adhurohen. Dikush i quan zota, por nuk e meritojnë të drejtën që e meriton Allahu, Zoti i botëve. Ai, i Lartësuari, ka thënë:

"O njerëz, veçoni Zotin tuaj (Allahun) me adhurim, Atë që ju krijoi juve dhe të gjithë ata që qenë para jush, që të jeni nga ata që arrijnë devotshmërinë (takua). **Është Ai që e bëri tokën vend për pushimin tuaj, e bëri qiellin si një kupë, zbriti ujin** (shiu) **nga qielli dhe nxori fruta si furnizim për ju. Atëherë mos i vendosni ortakë Allahut** (në adhurim) **ndërsa e dini** (se Ai s'ka ortakë)". Bekare, 22. Kjo fjali madhështore: la ilahe il'la Hue/Askush nuk meriton të adhurohet, përveç Tij, tregon mohimin e theksuar dhe absolut të një perëndie të vërtetë, përveç Allahut.

2-El-hajjul-kajjum- Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm (i Gjalli, Vigjiluesi).

I Gjallë vetvetiu, që nuk vdes asnjëherë

dhe Ai i mirëmban të tjerët. Të gjitha krijesat varen prej Tij, Ai nuk varet prej tyre, asgjë nuk mund të ekzistojë pa mirëmbajtjen e Tij, sikurse thotë I Lartmadhërishmi: **“nga argumentet e Tij është që me fuqinë e Tij bëri të qëndrojë (pa shtylla) qielli e toka”**. Gjallëria e Tij është e përsosur dhe asaj nuk i paraprin asgjë, në krahasim me krijesat që kanë gjallëri, por që Krijuesi i ka krijuar nga asgjëja.

3- La te'hudhuhu sinetun ue la neum. Atë nuk e kap as kotja, e as gjumi.

Allahu nuk ka thënë «Ai nuk fle», por ka thënë «Atë nuk e kap », me qëllim që të përfshijë gjumin që kaplon dhe gjumin me dëshirë. Nëse do të thoshim “Nuk fle”, kjo do të nënkuptonte se Ai nuk fle me dëshirë. Mirëpo Allahu i Plotfuqishëm nuk fle as nga kaplimi, as nga dëshira, sepse gjumi është një cilësi e papërsosur, e cila bie ndesh me përsosmërinë e Vetes dhe me përsosmërinë në raport me të tjerët. Personit që fle i humb shumë nga puna e tij, për shkak të këtij gjumi. Merrni parasysh, për shembull, rastin e një personi që ka shumë njerëz që punojnë për të dhe ai fle shumë. Ai s'ka mundësi të vejë në hesap apo të menaxhojë biznesin e çështjet e tjera, që kanë të bëjnë me këtë. Kjo pra, është papërsosmëria në raport me të tjerët.

Pejgamberi, salaAllahu alejhi ue selam, ka thënë: **“Vërtet, Allahu nuk fle dhe nuk i duhet të flejë”**, sepse Ai është syçelur dhe kontrollues absolut i çdo gjëje dhe se gjumi dhe kotja nuk është cilësi e Tij.

4- Lehu ma fis-semavati ue ma fil-erd. Gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij.

Me këto fjalë tregohet se të gjitha krijesat janë robërit e Tij, nën pushtetin, nënshtrimin dhe sundimin e Tij. Kur e di njeriu, se gjithçka ka në qiej dhe tokë është

e Tij, pse kërkon nga dikush tjetër. Tek Allahu janë depot e furnizimit të qiejve dhe të tokës dhe krijesa është e dobët, nuk zotëron as dëm e as dobi. I Lartmadhërishmi thotë: **“O ju njerëz ju jeni te varfër tek Allahu, ndërsa Allahu është i pasur dhe i falënderuar”**.

5-Men dheledhi jeshfeu indehu, il'la bi idhnihi. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pos me lejen e Tij?

Lejimi i Tij është i përgjithshëm. Madje edhe Muhamedi, salaAllahu alejhi ue selam, që ka pozitën më të lartë tek Allahu, s'mund të ndërmjetësojë ndryshe, përveçse me leje paraprake nga Allahu. Atij, salaAllahu alejhi ue selam, do t'i jepet kjo leje, pasi ai të bjeri në sexhde para Allahut e ta lavdërojë Atë me lavdërime madhështore, për të cilat Allahu do ta udhëzojë në atë Ditë. Atëherë do t'i thuhet: **“Ngrije kokën. Fol dhe do të dëgjohesh; ndërmjetëso dhe do të të pranohet”**. Dihet që askush s'ka pozitë më të lartë tek Allahu, sesa i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selam, por ai s'mund të ndërmjetësojë, përveçse me lejen paraprake nga Allahu. Kjo për shkak të përsosmërisë së autoritetit të Allahut të Madhërishëm. Sa më shumë të zbatohet autoriteti i mbretit, aq më shumë nderohet e respektohet ai.

6-Jaëlemu ma bejne ejdihim ue ma halfehum. E di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen

E ka përmendur i Lartësuar, diturinë e Tij të plotë dhe gjithëpërfshirëse për të gjitha gjërat e krijesave. E di çka ka para tyre dhe pas tyre. E di të fshehtën dhe të dukshmen dhe nuk i fshihet Atij, as sa grimca e atomit çka ka në qiej e në tokë. Ai e di çka ka ndodhur dhe çka do të ndodhë, edhe sikur të ndodhte ndryshe Ai e di se si do të ndodhte.

7- ve la juhitune bi shej-in min ilimih i la

bi ma shae. Nga ajo që Ai di, të tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar,

Askush nuk mund të dijë diçka nga dija e Allahut, pos asaj që i mësohet nga Allahu subhanehu ue Teala dhe Ai e njofton me atë gjë. Ka mundësi që kuptimi i këtyre fjalëve të jetë: Ata nuk mund të dinë nga vetë dituria dhe specifikat e saj, pos asaj të cilën Allahu subhanehu ue Teala ua ka mundësuar të dinë.

8-Vesia kursijjuhush-semauati uel erd. Kursija e Tij përfshin qiejt dhe tokën,

E përmend Taberaniu në tefsirin e tij, ku Vekiu përcjell nga Ibën Abasi, që thotë Kursija është vendi i pozicionimit të këmbëve të Allahut, ndërkaq Arshin askush nuk mund ta vlerësojë sa është. Transmetimi është i saktë sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit. Madhështia e Kursisë shprehet qartë në hadithin në të cilin Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, ka thënë: *“Në krahasim me Kursinë, shtatë qiejt dhe shtatë tokët s’janë gjë veçse si një unazë e hedhur në një shkretëtirë. I këtillë është Kursija në krahasim me Arshin (Fronin)”*.

9- ve la jeuduhu hifdhuhuma . Dhe kujdesi i Tij ndaj të dyjave nuk i vjen rëndë.

Allahun nuk e rëndon dhe nuk e mundon ajo që kujdeset dhe i mirëmban qiejt dhe tokën si dhe çdo gjë që është në to dhe ndërmjet tyre. Por kjo është e lehtë dhe e thjeshtë për të, Ai ka në kontroll çdo person dhe veprimtarinë e tij, i ka në mbikëqyrje të gjitha gjërat, asgjë nuk mund t’i ikë dhe të fshihet prej Tij.

10-ue huvel alijjul adhim. Ai është më i larti, më i madhi

Kjo fjali, me të dy kufijtë e përcaktuar të saj tregon veçanërisht, se vetëm Ai është më i larti, domethënë se Ai zotëron epërsi

absolute. Kurse për njerëzit është vërtetuar epërsia e kufizuar.

Çdo cilësi me të cilën Allahu e ka cilësuar veten është një cilësi e përsosur dhe në çdo aspekt është e pastër nga çfarëdo lloji të papërsosmërie.

Dobitë e Ajetul – Kursijit

- Pohimi i njësimi të Allahut në adhurim.

- Emri Allah është njëri ndër emrat e mëdhenj të Zotit dhe të gjithë emrat e tjerë i referohen emrit Allah.

- Me të drejtë për tu adhuruar është vetëm Allahu i Lartësuar.

- Pohimi dhe shënimi i emrit të Allahut “El-Hajj”, i Gjallë e i Përvetshëm.

- Pohimi i emrit të Allahut “El-Kajjum”, Mbajtësi (Mbizotëruesi i gjithçkaje).

- Njeriu për çdo çështje duhet t’i kthehet Krijuesit të tij.

- Allahun nuk e kap kotja dhe gjumi, pa dyshim që këto janë cilësi të mangëta me të cilat Allahu nuk cilësohet.

- Sundimi i Allahut është gjithëpërfshirës, Atij i përket gjithçka që ka krijuar.

- Njerëzit janë të varfër dhe kanë nevojë për Allahun e Lartësuar.

- Allahu pranon ndërmjetësimin dhe kjo ndodh vetëm me lejen e Tij.

- Dituria e Allahut është gjithëpërfshirëse dhe njeriu mund të dijë vetëm pak, sa ia bën të mundur vetëm Zoti.

- Kursija e Allahut është krijim madhështor i Tij dhe është më i gjerë se qiejt dhe Toka.

- Kujdesi i Allahut për qiejt dhe tokën nuk është i vështirë për Të, Ai është i Gjithëfuqishëm.■

AGJËRIMI I DITËVE TË SHEVALIT

Na përcillet se i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ka thënë:
*"Kush e agjëron muajin e Ramazanit, pastaj e pason atë me
agjërimin e gjashtë ditëve të muajit Sheval konsiderohet si të
ketë agjëruar të tërë kohën."*

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Këtë hadith e shënon Imam Muslimi, nr. 2750, 2751, 2752, Ebu Davudi, nr. 2433, Tirmidhiu, nr. 759, Nesaiu, Ibën Maxheh, nr. 1716. Ahmedi etj. Hadithin në fjalë e kanë përcjellë nga i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, disa shokë të tij: Ebu Ejub Ensariu, Xhabiri, Ebu Hurejre, Theubani, Ibën Abasi etj.

Rreth zinxhirëve të këtij hadithi ka pasur fjalë prej ca dijetarëve, të cilët i konsideronin si të dobët, por në të vërtetë mendimi më i saktë është se hadithi i përcjellë nga Ebu Ejub Ensariu është më se i saktë, sepse e transmeton Muslimi dhe hadithet e Sahihut të Muslimit janë të pranuar me konsensus si të sakta. Ndërsa

zinxhirët e tjerë arrijnë gradën e sahihut, duke u bashkuar njëri me tjetrin dhe duke u forcuar mes vete. Sido që të jetë hadithi është i saktë pa kurrfarë dyshimi.

Komentimi i hadithit:

Në këtë hadith Profeti, salallahu alejhi ue selem, na mëson një rregull dhe traditë të tij madhështore, e cila nëse praktikohet ka një shpërblim të madh dhe të pakapshëm në asnjë kohë tjetër. Ai, salallahu alejhi ue selem, tregon se besimtari pasi ta agjërojë muajin e madhërshtorë të Ramazanit është traditë profetike ta pasojë atë me agjërimin e gjashtë ditëve të muajit Sheval, i cili në fakt është muaji i dhjetë hënor dhe sipas radhës vjen pas atij të Ramazanit. Pra, hadithi i lartpërmendur nuk ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejt me Ramazanin, por

“Lejohet agjërimi i këtyre ditëve të ndara nga njëra tjetra, por sipas Imam Neveviut agjërimi i tyre bashkë njëra pas tjetrës është më i arsyeshëm...”

me muajin që vjen pas tij, Shevalin. Gjithashtu kjo këshillë dhe propozim profetik na tregon vlerën e këtij agjërimi, që me të vërtetë është një mirësi hyjnore e Allahut për robërit e Tij, të cilën Zoti ia dha këtij umeti. Ai tregon se është më mirë që të pasohet agjërimi i detyruar i Ramazanit me gjashtë ditë pas tij, të cilat në fakt nuk janë të detyruara, por janë propozim dhe traditë profetike, si rrjedhojë e së cilës arrihet një shpërblim i madh, e ai është sikur njeriu ta agjëronte të tërë jetën e tij.

Agjërimi i këtyre ditëve është mirë të pasohet menjëherë pas Bajramit, më saktësisht lejohet që nga dita e dytë e tij, sepse agjërimi i ditëve të para të të dy bajrameve është i ndaluar ngaqë janë ditë festash, të cilat duhet të shoqërohen me ushqime dhe pije të mira sipas mundësisë së njeriut. Mirëpo nëse ndodh të agjërohen në fund të këtij muaji nuk ka kurrfarë problemi. Lind pyetja pse është më mirë të agjërohen sa më afër ramazanit? Kjo për disa arsye:

- Sepse besimtari për një muaj të tërë është stërvitur me agjërim dhe do ta këtë më të lehtë shtimin edhe të gjashtë ditëve të tjera, e kur vonohet mund edhe t'i vështirësohet.

- Ngaqë ky agjërim konsiderohet si plotësim dhe përmirësim i lëshimeve dhe gabimeve të Ramazanit, siç falen namazet

sunete pas farzit, ku prej qëllimeve të tyre është edhe plotësimi i mangësive të farzit.

- Sepse fjala profetike “*Pastaj e pason* (pra, ramazanin)”, nënkupton pasimin sa më të shpejtë të tij, edhe pse kjo arsye e fundit është diskutueshme ndërmjet dijetarëve.

Lejohet agjërimi i këtyre ditëve të ndara nga njëra tjetra, por sipas Imam Neveviut agjërimi i tyre bashkë njëra pas tjetrës është më i arsyeshëm.

Shumica e dijetarëve janë të pajtimit se ky agjërim është sunet apo traditë profetike për të cilën besimtari shpërblehet nëse e pason dhe nuk dënohet nëse nuk e praktikon. Mirëpo për habi pati nga ata, të cilët e kundërshtuan duke e ndaluar një agjërim të tillë. Shkak për këtë gjë ishte frika e tyre se një gjë e tillë do të konsiderohej bashkëngjitje me Ramazanin e do të kalonte në rrezik duke menduar njerëzit, sidomos injorantët, se edhe ato ditë janë pjesë e Ramazanit dhe në këtë mënyrë, sipas tyre, mund të arrijnë deri tek shpikjet në agjërim, siç patën vepruar popujt para nesh të cilët vazhdonin t'i shtonin agjërimin të tyre ditë tjera derisa Allahu i mallkoi. Disa prej tyre deshën të argumentohen me rastin e mosfaljes së sunetit menjëherë pas farzit, por ndarjen e tyre mes vete me dhikër (përmendje të Allahut) dhe tesbih, edhe pse ky argument vetëm se e vërteton mendimin, i cili është kundër tyre.

Mirëpo ky mendim, aq më tepër i bazuar vetëm në një argument logjik dhe dyshim për një mundësi të tillë është jo i saktë. Dijetarët iu kundërpërgjigjën këtij mendimi, duke thënë se një frikë e tillë nuk ekziston, sepse këto ditë në fakt nuk janë të ngjitura me Ramazanin sa të mendojë dikush se janë pjesë e tij, përkundrazi mes tyre ekziston një ndarje e madhe, të cilën e përjeton çdo njeri madje edhe ai që nuk di shumë. Për sa i përket rastit të ndarjes së namazit farz me

atë synet përmes dhikrit dhe tesbihëve, edhe tek agjërimi kemi një ndarës të tillë, madje edhe më të madh se dhikri. Ne kemi ditën e bajramit, e cila është dhikër, tesbih, namaz, lutje, hutbe, festë, ushqim dhe pije, si çdo gjë tjetër përmes së cilës bëhet një ndarje më se e madhe mes agjërimit farz (Ramazanit) dhe atij sunet (gjashtë ditët).

Pati të tillë që u argumentuan me faktin se nuk kishin parë në vendin e tyre asnjë dijetar t'i agjëronte ato ditë. Por imam Neveviu i kundërvihet këtij mendimi me fjalën e tij: **“Hadithi i Profetit, salallahu alejhi ue selem, është argument edhe nëse disa njerëz nuk e njohin apo nuk e punojnë, qofshin ata edhe mbarë dynjaja”** (Sherh Sahih Muslim, 7/297).

-Lind pyetja: Si ka mundësi agjërimi i këtyre ditëve të konsiderohet si agjërim i një viti të plotë?

Përgjigja është në fjalën e Allahut që na thotë: **“Kush bën një vepër të mirë do t'i dhjetëfishohet shpërblimi i tij”** (En'am, 160). Gjithashtu këtë e sqaron edhe transmetimi i Ibën Maxhes në të cilin përmendet: *“Kush e agjëron ramazanin dhe pas bajramit i shton edhe gjashtë ditë konsiderohet si agjërim i tërë vitit, sepse kush vepron një punë të mirë do të shpërblehet dhjetëfish për të”*.

Pra, në Islam çdo vepër e mirë shpërblehet me së paku sa dhjetë punë të tilla, e vazhdon të shpërblehet sa shtatëqind të tilla, e ndodh të shpërblehet pa kufi.

Por lind pyetja: a thua ky shumim i shpërblimit për punë të mira është mirësi e Allahut vetëm për umetin e Muhamedit, salallahu alejhi ue selem, apo ishte edhe për popujt e tjerë?

Nuk ka dyshim se kjo mirësi është veçori vetëm e këtij umeti. Por kush është fshehtësia e kësaj veçorie dhe mirësie? Duke pasur parasysh se popujve të tjerë

Allahu u dha jetë shumë më të gjatë, se ajo e umetit tonë, ata edhe patën mundësi të punojnë shumë punë, të cilat nëse krahasohen në numër me ato të këtij umeti janë shumë më tepër. E duke e ditur se Allahu është i Drejtë me robërit e tij deshi që këtë umet mos ta lërë mbrapa me shpërblime, por ua shtoi dhjetëfish shpërblimin për çdo vepër të mirë të tyre. E gjitha kjo në mënyrë që t'i arrijnë në shpërblim besimtarët e popujve të mëhershëm, të cilët patën mundësi që të jetonin qindra apo edhe mijëra vite. Këtu është edhe një mirësi tjetër me të cilën ky umet u veçua, ajo është se Allahu nga dashuria që kishte për ta nuk i la të jetonin shumë në këtë botë e të lodheshin duke u munduar të punojnë shumë, qoftë për këtë apo për botën tjetër, mirëpo ua shumëfishoi sevapet e një pune duke mos u lodhur si të tjerët para nesh, e pastaj i merr tek Vetja e Tij që t'i shpërblejë. Iu dha jetë më e shkurtër se çdo popull tjetër, sepse kjo botë, siç thotë edhe i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, *“është burg për besimtarin”*, prandaj Allahu nuk e le shumë në burgun e Tij atë që e do, por e nxjerr në liri sa më shpejt të jetë e mundur.

-Thamë se agjërimi i Ramazanit dhe i gjashtë ditëve të Shevalit konsiderohet si agjërim i tërë vitit, por kjo kurrësi nuk aludon se agjërimi i tërë vitit është i parapëlqyer sipas Islamit. Kjo për vetë faktin se është vepër e shpikur, të cilën argumentet fetare e kundërshtojnë.

I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, në një hadith të tij tregon se *“agjërimi më i mirë është ai i Davudit, alejhi selam, i cili një ditë agjëronte e tjetrën jo”*. Kur u pyet se a ka më mirë se kjo mënyrë ai u përgjigj: **“JO”**.

Zoti ua shtoftë veprat e mira të gjithë besimtarëve dhe i pranofte ato! ■

PREZANTIM I LIBRIT:

“FURNIZIMI PËR AHIRET”

MR. ABDULMEXHID SHEMSUDIN

Falënderimi i takon vetëm Allahut, subhanehu ue teala, Atë e lavdërojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë, udhëzim dhe falje kërkojmë. Mbështetemi tek Allahu, subhanehu ue teala, nga të këqijat e vetvetes dhe të veprave tona. Kë udhëzon Allahu, subhanehu ue teala, s’ka kush që mund ta lajthisë, e kë lajthit Allahu, subhanehu ue teala, s’ka kush që e udhëzon në rrugë të drejtë. Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe se Ai nuk ka rival. Po ashtu dëshmoj se Muhamedi, është rob dhe i dërguari i Tij.

Vepra “Muhtesar Zadul Me’adi” e reformatorit të thirrjes Islame të kohës së



tij, dijetarit Muhamed b. Abdulvehab llogaritet ndër veprat përmbledhëse shumë të dobishme, siç është edhe rasti me veprat e tjera të mësuesit të këtij dijetari. Libri me pak fjalë paraqet udhëzimin e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, për të gjitha segmentet dhe sferat e jetës së njeriut, si të asaj fetare ashtu edhe ato të kësaj bote.

Autori ka përmbledhur veprën “Zadul Me’adi fi Hedji Hajril Ibad” të autorit të mirënjohur Ibën Kajim el-Xheuzijje, ai i ka larguar pyetjet e fikhut, polemikat, diskutimet, sugjerimet, replikat, përfundimet dhe përparësitë për atë që argumentet tregojnë. Ai ka përzgjedhur prej këtij libri vetëm atë që lidhet drejtpërdrejtë me udhëzimin e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, për këtë Allahu e shpërbleftë.¹

¹ Marrë nga parathënia e originalit të botuar nga shtëpia botuese Dar Ibën Hazëm.

Gjatë përpunimit dhe krahasimit të përkthimit të tekstit kemi shfrytëzuar katër shembuj të përmbledhjeve të librit në gjuhën arabe. Disa nga shembujt kanë qenë të botuar me fusnota e disa edhe me burimin e haditheve. Përveç versionit të shkurtuar të librit ne kemi shfrytëzuar edhe versionin origjinal të veprës “**Zadul me’ad**”, recensimin dhe burimet e haditheve të së cilës i kanë bërë Shejh Abdulkadër Arnauti dhe Shejh Shuaib Arnauti.

Shumicën e shpjegimeve nëpër fusnota e kemi marrë nga librat e përmbledhura dhe të lartpërmendura, e disa i kemi marrë nga vepra origjinale “**Zadul me’ad**” mbi të cilën gjithashtu është bërë një recensimin i përshtatshëm.

I kemi përmendur edhe disa shpjegime në poshtëshënimet për të cilat kemi llogaritur se janë të nevojshme për lexuesit e këtij vendi.

Në përmbledhjen e bërë autori në një vend e ka përmendur se mendimi më i drejtë është i kundërt me atë që Ibën Kajim el-Xheuzije e ka llogaritur si të drejtë në origjinalin. Kemi menduar se duhet që të paralajmërojmë për këtë gjë. Kemi përmendur mendimet edhe të dijetarëve të tjerë në vendet ku Ibën Kajimi ka përmendur mendime të dobëta, ose nuk i ka përmendur të gjitha mendimet. Kjo nuk duhet që të kuptohet si kritikë ose kundërshtim të asaj që ka shkruar autori, sepse ai ka përmendur se nuk ka dashur që me anë të këtij libri të shpjegojë mendimet e medhhebeve, por që të shpjegojë udhëzimin e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem.

Muhammed b. Abdulvehab

Shejhul Islam Muhammed b. Abdulvehab b. Sulejman el-Vuhejbi et-

Temimi rahimehullah, është lindur në vitin 1115 sipas hixhretit në Ujejne, ku edhe është rritur. Njohuritë e para i ka marrë nga babai i tij, i cili ka qenë kadi (gjykatës) në atë qytet. Ka udhëtuar duke kërkuar dituri në Nexhd, Ahsa, Hixhaz dhe Basra. Pas kësaj është kthyer në Nexhd, ndërsa Allahu, subhanehu ue teala, ia ka hapur gjoksin për të vërtetën me të cilën Allahu, e kishte dërguar Pejgamberin më të zgjedhur Muhamedin, salAllahu alejhi ue selem. Ai e kishte vërejtur me kohë largimin e njerëzve nga parimet fetare, sepse ndërmjet tyre kishin marrë hov bidatet (risitë) dhe lajthitjet (dalaleti). Për shkak të gjithë kësaj i thirri ata në Kuran dhe Sunet, i ka thirrur dijetarët që ta përmirësojnë besimin te njerëzit, sepse në të kishin hyrë shumë të pavërteta dhe lajthitje. I ka thirrur pushtetmbajtësit që ta pasojnë Sunetin e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, e t’u kundërvihen lajthitjeve dhe humbjeve. Këto veprime e kanë ekspozuar atë ndaj hidhërimit të interesaxhinjve dhe të atyre që u ka leverdisur ajo gjendje, e për këtë edhe është detyruar që të shpërngulet në Dir’ije (vend afër Rijadit sh.p.). Pasi është vendosur atje ka bërë një marrëveshje me udhëheqësin vendas Muhamed b. Saud, i cili i është përgjigjur thirrjes së vërtetës dhe ka dalë në mbrojtje të së vërtetës.

Me këtë bashkim Allahu, subhanehu ue teala, i ka shkatërruar kurthet dhe mashtrimet e pushtetmbajtësve dhe të dijetarëve të këqij, të cilët e kanë shfrytëzuar prej kohësh këtë gjendje. Thirrja dhe librat e tij janë përhapur në të gjitha vendet e afërta dhe të largëta. Ai ka ndërruar jetë në vitin 1206 sipas hixhretit. ■

AZERBAIXHANI



Azerbaixhan - Emri zyrtar: “Republika e Azerbaixhanit”. Kryeqytet: Baku. Popullsia: 7.7 milionë. Monedha: Manati. Gjuha Zyrtare: Azerbaixhanishtjs. Sipërfaqja: 86.600 km².

Pozita gjeografike: Azerbaixhani është i vendosur në anën perëndimore të Detit Kaspik dhe është e para republikë sovjetike, e cila deklaroi pavarësinë. Kryeqyteti i saj është Baku, një qytet i vjetër dhe porti më i mirë në Detin Kaspik.

Gjendja politike: Azerbaixhani e ka fituar pavarësinë në vitin 1992. Partia **Azerbaixhani i Ri** zëvendësoi komunistët që ishin në pushtet në vitin 1995 dhe i dominoi përsëri zgjedhjet e vitit 2000, të cilat u kritikuan nga vëzhguesit si me shumë probleme. Kjo parti mbështet presidentin 70-vjeçar **Hajdar Alijev**, i zgjedhur së pari në vitin 1993 dhe rizgjedhur në vitin 1998.

Politika e Jashtme: Azerbaixhani është anëtar i OKB-së nga viti 1992. Përfundimi, po aq sa Irani dhe Rusia janë të interesuar

për fushat e naftës azere në Detin Kaspik. Marrëdhëniet me Rusinë e presidentit Putin janë përmirësuar. Turqia me historinë dhe kulturën e përbashkët shihet si një aleat natyral. Azerbaixhani iu bashkua Këshillit të Evropës në vitin 2001.

Ekonomia: Vendi është shumë i pasur me burime naftë. Të ardhurat për frymë janë 460\$ në vit dhe në bazë të prodhimit kombëtar renditet në vendin e 121 në botë. Infrastruktura është e varfër dhe industria është ajo çka ka mbetur nga regjimi sovjetik. Fushat e naftës të Detit Kaspik kanë tërhequr vëmendjen ndërkombëtare, si dhe ka sasi të mëdha gazi në det.

Popullata dhe Shoqëria: Mijëra armenë, hebrenj dhe rusë janë larguar për shkak të rritjes së ndjenjës nacionaliste azere. Sistemi shoqëror i gjithi tashmë është në një krizë të theksuar. 61% janë Shia-Ithna asherije, Muslimanë Sunitë 26%, të tjerë 13%. 57% e popullsisë jetojnë në qytet dhe 43% në fshat, ndërsa dendësia e popullsisë është 118 vetë/km².

RREGULLA DHE DISPOZITA RRETH GJASHTË DITËVE TË MUAJIT SHEVAL

PËRGATITI: AGIM BEKIRI

1. Cili është vendimi i shariatit për agjërimin e gjashtë ditëve të muajit Sheval?

Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval pas agjërimin të Ramazanit është një vepër e pëlqyer. Pra, për besimtarin ligjërohet agjërimi i këtyre gjashtë ditëve dhe për këtë fiton shpërblim të madh tek Allahu. Ai që i agjëron këto ditë shpërblehet sikur të kishte agjëruar të tërë vitin, sepse Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kush agjëron Ramazanin pastaj i bashkëngjit edhe gjashtë ditë prej Shevalit është sikur të kishte agjëruar të tërë kohën.”* E përcjell Muslimi.

Në disa transmetime të tjera qëndron: *“Kush agjëron gjashtë ditë pas Fitër Bajramit është sikur të ketë agjëruar një vit të plotë.”*, **“Kush vjen me një (punë) të mirë, ai (në Ditën e Gjykimit) shpërblehet dhjetëfish.”** En’am: 160”. Në një transmetim tjetër thuhet: *“Allahu të mirën e shpërblen dhjetëfish, një muaj me dhjetë dhe agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit është plot një vit.”* E përcjell Nesaiu, Ibën Maxheja, hadithi është sahih.

Muhammed b. Salih El-Munexhid



Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në revista@albislam.com

2. Kur duhet filluar me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevalit, a detyrohem menjëherë pas ditës së parë të Bajramit?

Agjërimin e këtyre ditëve mund ta fillojmë menjëherë pas ditës së parë të Bajramit, mirëpo një gjë e tillë nuk është detyrim, sepse mund të fillohet edhe me vonë, dy, tre apo më shumë ditë pas festës. Komisioni i Përhershëm për Fetva i dha këtë përgjigje pyetjes së mësipërme: “Nuk detyrohem të fillojmë agjërimin e këtyre ditëve menjëherë pas ditës së parë të Bajramit, por lejohet edhe më vonë, varësisht si është më e lehtë për çdo besimtar. Çështja lihet në lirinë e çdonjërit, sepse agjërimi i këtyre ditëve nuk është detyrim por sunet.”

Fetfatë e Komisionit të Përhershëm
10/39

A detyrohem që gjashtë ditët e Shevalit t'i agjërojmë njëpasnjëshëm apo mund të agjërohen të ndara?

Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit është sunet i vërtetuar nga Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, dhe lejohet të agjërohen një pas një, ose të ndara, sepse Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, nuk e përcaktoi që këto ditë të agjërohen njëpasnjëshëm apo të ndara. Ai tha: “*Kush e agjëron Ramazanin dhe pastaj ia bashkëngjit edhe gjashtë ditë prej Shevalit është sikur të kishte agjëruar të tërë kohën.*” E përcjell Muslimi.

Fetava Ibën Baz 15/391

4. A lejohet të agjërojmë gjashtë ditët e Shevalit para kompensimit të ditëve të Ramazanit që na kanë mbetur kaza (për kompensim)?

Dijetarët nuk kanë rënë në ujdi lidhur me këtë çështje. E sakta është që një herë neve na duhet t'i kompensojmë ditët e Ramazanit, që na kanë mbetur kaza, pastaj të agjërojmë ditët e Shevalit që janë nafile, sepse Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “*Kush agjëron Ramazanin pastaj i bashkëngjit gjashtë ditët e Shevalit është sikur të kishte agjëruar të tërë kohën.*” E përcjell Muslimi.

Fetava Ibën Baz 15/392

5. Gruaja që nuk ka agjëruar disa ditë të Ramazanit për shkak të ciklit mujor, a mund të fillojë me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevalit pas ditës së Bajramit?

Nëse dëshiron të arrijë shpërblimin e përmendur në hadithin “*Kush agjëron Ramazanin pastaj i bashkëngjit edhe gjashtë ditë prej Shevalit është sikur të kishte agjëruar të tërë kohën*”, atëherë duhet t'i plotësojë ditët e Ramazanit pastaj të agjërojë gjashtë ditët e Shevalit.

Nëse e shikojmë çështjen nga aspekti i lejimit atëherë themi se i lejohet asaj të vonojë kompensimin deri në prag të Ramazanit të ardhshëm.

Muhamed b. Salih El-Munexhid

6. A lejohet që gjatë agjërit të gjashtë ditëve të muajit Sheval të bëjmë nijet edhe kompensimin e ditëve të Ramazanit që na kanë mbetur kaza, pra, të bashkojmë nijetet dhe të kryejmë dy ibadete?

Kjo është një çështje e rëndësishme rreth së cilës shpeshherë parashtrohen pyetje. Në lidhje me këtë them:

Detyrohem të dimë se disa vepra janë me vlerë të caktuar në vetvete dhe disa të tjera janë të përgjithshme. Për shembull: namazi i Duhasë dhe ai i Tehijjetul

mesxhidit. Po të thellohem në hadithet e Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, lidhur me këto dy namaze do të vërejmë se namazi i Duhasë ka një status të caktuar dhe një vlerë të veçantë, kurse namazi i Tehijjetul mesxhidit nuk është ashtu, sepse ai që hyn në xhami dhe fal farzin paraprak apo sunetin e sabahut, apo namazin e istihares apo e gjen xhematin në namaz dhe iu bashkëngjitet atyre, në të gjitha këto raste ai e ka kryer detyrimin e Tehijjetul mesxhidit dhe nuk ka bërë fare gabim dhe nuk detyrohet ta kompensojë namazin e Tehijjetul mesxhidit. Së këndejmi, del në pah urtësia e Ligdhënësit, i cili e ka ndaluar atë që hyn në xhami të ulet para se të falet, mirëpo nuk e ka urdhëruar me ndonjë namaz të caktuar, porse çfarëdo namazi që do të falë do të jetë zbatues i këtij urdhri. Nëse hyn në xhami për namazin e drekës dhe fal dy rekate me nijet të Tehijjetul mesxhidit, nuk llogaritet se i ka falur sunetet e Drekes, mirëpo nëse hyn dhe i fal sunetet e drekës ai ka zbatuar urdhrin e Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, kur na thotë që të mos ulemi para se t'i falim dy rekatë. Po ashtu nuk duhet të kompensojë rekatet e Tehijjetul mesxhidit. Në anën tjetër nëse ai fal Tehijjetul mesxhidin dhe thirret ikameti për të hyrë në farz, ai ka të drejtë të kompensojë rekatet e sunetit të Drekes. Kur njeriu ta kuptojë se cilat vepra i ngjajnë "Tehijjetul mesxhidit"; e cilat "namazit të Duhasë" e zgjidh dilemën e parashtruar në këtë pyetje.

Prej punëve që i ngjajnë Tehijjetul mesxhidit është agjërimi i ditës së Hënë dhe të Enjte, për arsye se këto dy ditë nuk kanë vlerë të veçantë e të përcaktuar në vetvete siç janë agjërimi i Ditës së Arafatit dhe Ashurasë për shembull, porse me agjërimin e tyre qëllimi është që në këto dy ditë veprat ngrihen tek Allahu e

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, dëshironte që të jetë agjërueshëm kur ngrihen veprat e tij. Sikur ndonjëri të agjërojë të Hënë dhe të Enjte me nijetin e kompensimit të kazasë, agjërimin të zotuar, agjërimin shpagues (kefaret), ditët e Shevalit apo Ditët e Bardha qëllimi do të arrihet, pra, veprat e tij do të ngrihen tek Allahu duke qenë agjërueshëm. Për këtë arsye e pëlqejmë për atë që dëshiron të agjërojë ditët e Shevalit, që këtë gjë ta bëjë të Hënë dhe të Enjte dhe këtu nuk themi se nijetet bashkohen, sepse agjërimi i të Hënës dhe të Enjtes nuk kanë vlerë të vetën të veçantë e të caktuar, madje as që mundet të bëhet bashkimi i nijeteve të veçantë me një të përkufizuar.

Pra, më e sakta është se nuk lejohet bashkimi i nijeteve të dy ibadeteve, ku çdonjëri prej të cilit ka mëvetësi në vlerën e tij, për shembull nuk bashkohen nijetet e agjërimin kaza dhe agjërimin të zotuar, as nijetet e agjërimin kaza dhe gjashtë ditëve të Shevalit, sepse qëllimi që shprehet në hadithe është që njeriu të agjërojë 36 ditë apo një muaj e gjashtë ditë, për ndryshe nëse bashkon nijetet ai do të agjërojë vetëm një muaj. Kjo gjë është në kundërshtim me qëllimin e hadithit, i cili është sqaruar në transmetimin e Ibën Maxhes me sened të vërtetë, ku thuhet: *"Kush agjëron gjashtë ditë pas Fitër Bajramit për të llogaritet plot një vit. Kush bën një të mirë atij do t'i shpërblehet dhjetëfish."*

Ihsan b. Muhammed b. Ajish El-Utejbi

7. Fillova të agjëroj gjashtë ditët e Shevalit, mirëpo nuk munda t'i plotësoj për disa shkaqe dhe disa punë të mia. Muaji i Shevalit përfundoi, kurse mua më mbetën dy ditë pa agjëruar, a më lejohet t'i kompensoj këto

ditë apo çfarë të bëj?

Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit është një adhurim i pëlqyer e jo i domosdoshëm. Ti e ke fituar shpërblimin e ditëve që ke agjëruar dhe shpresohet të marrësh agjërimin e plotë të gjashtë ditëve, nëse pengesat që nuk të kanë lënë t'i plotësosh ato ditë janë të pranuar me shariat, meqë Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kur njeriu sëmuret apo del në udhëtim, Allahu e shpërblen atë ashtu sikur të ketë vepruar kur ka qenë i shëndoshë dhe në vendin e tij.”* E përcjell Buhariu. Pra, nuk duhet që t'i kompensosh ato ditë që të kanë mbetur, e Allahu e jep suksesin.

Fetava Ibën Baz 5/270

8. Cilat janë dobittë e agjëritit të gjashtë ditëve të Shevalit?

Po përmendim disa dobi të agjëritit të këtyre ditëve:

me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevalit plotësohet shpërblimi sikur të ishte realizuar agjërimi pandërprerë të tërë vitin.

agjërimi i Shevalit po edhe i Shabanit janë si sunetet e rregullta që janë para dhe pas namazeve farz. Ky agjërim i plotëson lëshimet dhe gabimet e mundshme, që bëhen gjatë kryerjes së farzit, sepse farzet do të kompensohen me nafile ditën e Kijametit. Shumica e njerëzve bëjnë gabime dhe lëshime gjatë agjëritit të detyrueshëm, prandaj kanë nevojë që gabimet e tyre t'i përmirësojnë me vepra vullnetare.

rrekja për të agjëruar pas Ramazanit është sinjal për pranimin e agjëritit të Ramazanit, sepse kur Allahu pranon

veprën e ndonjërit e drejton te një vepër tjetër e mirë. Disa dijetarë kanë thënë: shpërblimi i një të mire është e mira që bëhet pas. Kush bën një të mirë pastaj vijon me një të mirë tjetër, ky është një sinjal për pranimin e veprës së parë, ashtu siç sinjalizon vepra e keqe pas një të mire mospranimin e të mirës tek Allahu.

Agjëruesve të Ramazanit shpërblimet e tyre u ndahen ditën e Bajramit. Ajo është ditë e shpërblimeve, prandaj rikthimi me agjërim në ditët e Shevalit konsiderohet si falënderim për këto begati. Begati më të madhe se sa falja e mëkateve nuk ka. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, falte namaz nate derisa i ënjteshin këmbët. Kur i thuhej: *E bën këtë e Allahu t'i ka falur të gjitha gabimet e shkuara dhe ato të ardhme?! Ai përgjigjej: A të mos jem rob falënderues?! Allahu, subhanehu ue teala, robërit e tij i urdhëroi ta falënderojnë begatinë e agjëritit duke e përmendur Atë, Ai tha: “(Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) ***Që të plotësoni numrin, ta madhëroni Allahun për atë se ju udhëzoi dhe që të falënderoni.***” (Bekare – 185) Prej falënderimit për dhuntinë e agjëritit të Ramazanit është agjërimi i ditëve të Shevalit më pas. Disa muslimanë të gjeneratave të para kur falnin namaz nate të nesërmen gdhieheshin agjërues që me këtë të falënderojnë Allahun për dhuntinë e faljes së namazit të natës. Uehb b. Uirdi kur pyetej për shpërblimet e disa ibadeteve siç është Tavafi dhe të tjera thoshte: Mos pyetni për shpërblimet e këtyre veprave, por pyetni se si duhet të falënderojmë, kur na mundësohet nga Allahu ta bëjmë atë vepër të mirë. ■*

Hafidh b. Rexheb

HISTORIA E PALESTINËS SË VJETËR DHE BANORËT E SAJ

Ne në këtë rrëfim mësojmë dhe marrim vesh kush janë çifutët, si popull i Izraelit, të cilët përmenden në rrëfimin e pejgamberit të tyre Musait, alejhi selam. Në këtë rrëfim ka shembuj dhe mësimë për ata që dëshirojnë të zbulojnë falsifikimet dhe të shohin vërtetësinë në lidhje me ta.

TARIK SUVEJDAN

Banorët e parë

Askush nuk e di saktësisht, kur është ngritur vendbanimi i parë në tokën e Palestinës dhe as nuk ka argument që ta përkufizojë ndonjë histori, por shenjat dhe gjurmët e para tregojnë se banorët e parë që e kanë banuar Palestinën janë të shekullit të katërmëdhjetë para erës sonë (shek XIV p.e.s.) e ata janë një bashkësi fisesh, që quheshin Natufij.

Në shek. VIII p.e.s. ka gjurmë që tregojnë për ekzistencën e një qyteti që sot njihet me emrin: “**Urejha**”. Për këtë shkak disa hulumtues e konsiderojnë këtë qytetin më të vjetër në botë.

Kenan-itët

Gjurmët e para që dihen, sillen rreth popullit të quajtur **Kenan-it** dhe të tjerë që quhen **Amur-it**. Këta dy popuj janë fise që janë shpërngulur nga Gadishulli Arabik nga veriu dhe janë vendosur në Sham, pikërisht në Palestinë. Kjo gjë është e verifikuar dhe e qartë në lidhje me historinë e Palestinës. Për këtë janë në konsensus historianët e Orientit dhe ata të Perëndimit. Domethënë zanafilla e historisë së arkivuar kthehet te banorët e parë të Palestinës, e ata janë Kenanitët dhe

Amuritët. Për sa u përket çifutëve, ata nuk përmenden gjatë kësaj periudhe historike. Ata përmenden pas shumë shekujsh.

Fiset arabe që kanë emigruar prej Gadishullit Arabik në drejtim të veriut kanë qenë të shumta. Këta janë ndarë në tokat e Shamit dhe dy lumenjve (Eufrat dhe Tigër) në Irak. Një pjesë e tyre është transferuar në Egjipt. Prej tyre kanë qenë Kenanitët, të cilët u vendosën në brigjet e Palestinës. Prej tyre kanë qenë edhe **Jebisinët**, të cilët u vendosën në tokat e Kudsit para se të ndërtohej. Popujt e tjerë janë ndarë dhe janë vendosur në pjesën malore dhe janë quajtur **Fenikas** dhe Amurit. Kështu u nda toka e Palestinës në mes fiseve. Librat e historisë i kanë përmendur në bazë të gjurmëve dhe dëshmive emrat e çdo fisi nga këta dhe sipas shpërndarjes gjeografike në territorin e Palestinës.

Për këtë shkak toka e Palestinës nga dijetarët e historisë quhet Toka e Kenanitëve, si përkatësi e tyre. Kjo është e theksuar tekstualisht në librat qiellorë, prej tyre Tevrati dhe Inxhili.

Zanafilla e emrit Palestinë

Zanafilla e emrit Palestinë rrjedh prej popullit që ka banuar në vendin e quajtur **Balsat** në jug të Palestinës (së sotshme).

Emri “Palestinë” rrjedh edhe nga popujt e tjerë, që kanë ardhur nga ishujt e Detit



Mesdhe, pikërisht nga ishulli i Kretës. Siç duket popujt e këtyre ishujve i ka kapluar uria apo ndonjë fatkeqësi tjetër, që i ka bërë të ikin në drejtim të brigjeve të Shamit dhe Egjiptit. Atyre u doli në pritë **Ramsesi III** në betejën e njohur të “**Luzinit**”, e cila është zhvilluar në Egjipt. Ramsesi nuk dëshironte që ata të vendosen në tokat e Egjiptit. Pas negociatave vendosën që ata të transferohen në Palestinë. Ramsesi i urdhëroi të vendosen në pjesën jugore të Palestinës, në vendin e quajtur Belsat, ndërkaq ata u quajtën **belsetinas**. Prej këtij derivati ka ardhur edhe emri Palestinë dhe banorët e saj janë njohur si “belsetin”. Kohë pas kohe emri është shndërruar derisa ka arritur të thirret me formën e sotshme Palestinë. Këta popuj u bënë kështu fqinjë të Kenanitëve dhe Bujusinëve, të cilët ishin banorët vendas të atyre anëve. Që aty ata u përzier dhe kështu u shkriën me vendasit, që ishin në numër më të madh dhe me civilizim më të përparuar. Me kalimin e kohës balsetinët dhe kenanitët

u zhdukën dhe nuk u ka mbetur gjurmë prej tyre, kështu që u kanë humbur edhe gjurmët e tyre historike.

Nga e gjithë kjo që u tha më sipër na qartësohet se në këtë periudhë nuk hasim në ndonjë rast ku të përmenden çifutët e as popujt e tyre. Atëherë ku kanë qenë në këtë periudhë? Si kanë hyrë në territoret e Palestinës?!...

Në histori është përmendur se Ibrahimit alejhi selam në Palestinë i kanë lindur dy djem: Is’haku dhe Ismaili. Ata ishin nga të shpërngulurit dhe jo nga vendasit. Jakubi alejhi selam i quajtur **Israil** ishte i biri i Is’hakut alejhi selam. Jusufi alejhi selam ishte njëri nga bijtë e Jakubit. Në Kuranin Fisnik thuhet se Jusufin e kanë marrë si skllav në Egjipt e pastaj Allahu i ka dhënë pozitë të lartë në qeverisje dhe i ka mësuar komentimin e ëndrrave. Pastaj bëhet ministër i ekonomisë të Egjiptit. Duke qenë në këtë pozitë ka kërkuar t’i sjellin babanë e vet Jakubin me të gjithë anëtarët e familjes e t’i

bashkohen atij në Egjipt. Në Librin Famëllartë thuhet:

“Ju shkoni me këtë këmishën time dhe hidhjani atë babait tim në fytyrë, e atij do t’i kthehet shikimi, e pastaj ejani tek unë me tërë familjen time”. Jusuf 93

“(e morën familjen dhe shkuan) E kur hynë te Jusufi, ai i afroi nga vetja të dy prindërit e tij dhe tha: “Me dëshirën e Allahut hyni në Egjipt të sigurt!” Jusuf 99

Jakubi alejhi selam i ka marrë të gjithë anëtarët e familjes dhe është vendosur në Egjipt, e prej aty nuk ka dalë më. Kështu ka mbaruar emigrimi i tyre nga Palestina.

Emigrimi tjetër i çifutëve në Palestinë është ai i Musait alejhi selam, kur bëri hixhret me popullin e tij Beni Israil nga Egjipti, që të shpëtojnë nga Faraoni dhe ushtria e tij. Prej këtu vërejmë se çifutët kanë hyrë në Palestinë si muhaxhirë (emigrantë). E sa u përket banorëve vendas ata kanë qenë Kenanitët. Drejtimi i shpërnguljes ka qenë më shumë nga Egjipti në Palestinë, edhe pse Palestina i përkiste Egjiptit administrativisht, politikisht dhe historikisht, që prej kohës kur Jakubi alejhi selam e ndërtoi tempullin. Në këtë kohë faraonët patën filluar të zgjerohen në territoret më të afërta dhe kështu e pushtuan Palestinën e pikërisht territoret që i pat sunduar Heksosi. E kështu Palestina është bërë pjesë e Egjiptit,

Allahu i begatoi Beni Israilët dhe i shpëtoi nga faraoni, ndërsa faraonin me ushtrinë dhe pasuesit e tij i mbyti në det. Ne në këtë rrëfim mësojmë dhe marrim vesh kush janë çifutët, si popull i Izraelit, të cilët përmenden në rrëfimin e pejgamberit të tyre Musait, alejhi selam. Në këtë rrëfim ka shembuj dhe mësimë për ata që dëshirojnë të zbulojnë falsifikimet dhe të shohin vërtetësinë në lidhje me ta.

Musai alejhi selam dhe çifutët (1250 p.e.s)

“...Allahu iu dha atyre një ndëshkim shumë të rreptë dhe e ka bërë dënimin e tyre të vazhdueshëm deri në Ditën e Gjykimit...”

Musai alejhi selam në Egjipt

Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Përkujtoni edhe kur ju shpëtuaam prej popullit të faraonit, që nga ai shijuat dënimin më të hidhur, duke ua therur bijtë tuaj, e duke ua lënë gjallë gratë tuaja. Në këtë torturë përjetuat një sprovim të madh nga Zoti juaj.”* Bekare 49

Paraqitja e Musait në histori është rreth 1250 vite p.e.s. Allahu e ndihmoi me muxhize (mrekulli) të hatashme e të shumta. Fillimisht me inspirimin e Nënës së Musait për ta hedhur në lum e pastaj të rritet në pallatin e Faraonit zullumqar, i cili e kishte skllavëruar popullin e Egjiptit. Allahu i Madhëruar na rrëfen në Kuran, se kur Musai u rrit dhe u bë burrë e vrau pa dashje një egjiptian. Pastaj largohet prej aty duke ikur prej Faraonit dhe parisë së tij. Allahu ia zbriti shpalljen dhe e urdhëroi me kumtim që t’i nxjerrë njerëzit nga adhurimi i Faraonit në adhurimin e Allahut të vetmit. Ai i mori Beni Israilët nga Egjipti, e Allahu i ka bashkuar lutjes tij mrekullia e shkopit që shndërrohej në një gjarpër të madh. Një muxhize tjetër ishte ajo kur e fuste dorën në kraharor dhe kur e nxirrte bënte dritë. Musai alejhi selam e sfidoi Faraonin para të gjithëve nga Beni Israilët dhe parisë së tij. Si rezultat i kësaj ishte të besuarit e shumë nga Beni Israilët dhe magjistarët në atë që kumtonte Musai alejhi selam. Ata besuan në Zotin e Musait dhe Harunit dhe e

mohuan Faraonin me parinë e tij. Pastaj Allahu i shpalli Musait alejhi salam, se Faraoni do t'u ngrejë kurth dhe ata e lëshuan Egjiptin dhe u nisën në drejtim të Palestinës. Ata u arritën nga Faraoni me ushtrinë e vet, saqë pothuajse i kapi në bregun e detit, në njërin nga brigjet e Detit të Kuq e më saktësisht në anën e majtë. Aty Allahu ia hapi detin Musait dhe pasuesve të vet dhe ata kaluan në një rrugë të thatë. Pas iu ishin vënë Faraoni me ushtrinë e vet. Pasi Musai me popullin e vet kaluan në anën tjetër, Allahu e mbyti Faraonin dhe ushtrinë e tij. Kështu Allahu i shpëtoi dhe i begatoi ata duke iu dhënë siguri e qetësi pasi kishin kaluar më parë tortura dhe rronin të frikësuar.

Jehuditë në Palestinë

Musa alejhi salam në **Sina'**

Kur shkoi Musai alejhi salam me popullin e tij në tokën e Sinait, aty gjetën një popull që adhuronin idhujt. Populli i Musait i tha Musait alejhi salam, ***"Na bëj neve idhuj ashtu siç kanë këta zota"***. Musai alejhi salam u çudit me kërkesën e tyre dhe i përshkroi ata si injorantë. Si ka mundësi që ky popull i ka parë dhjetë mrekulli madhështore, nga të cilat e fundit që' ndarja e detit e megjithatë kërkojnë të adhurojnë zota të tjerë përpos Allahut. Këtu ishte edhe fillimi i çrregullimit të tyre në besim, që njëkohësisht e kanë pasur të ngulitur edhe në shpirtrat e tyre. Kjo gjë shkaktoi habi të madhe tek Musai dhe vëllai i tij Haruni alejhima salam me këtë popull. Ai u tha atyre ***"Beni israilët i kaluam përtej detit, e ata u takuan me një popull që adhuronin do statuja të tyre, dhe thanë: "O Musa, na e bën edhe neve një zot (statujë) si zotat që i kanë ata (ai popull)". Ai (Musai) tha: "Ju jeni popull që nuk di"***. (Araf 138). Jehuditë kishin përvetësuar kufrin (mosbesimin) dhe adhurimin e idhujve qysh para shumë shekujsh, kur kishin kaluar nën shërbimin e

Faraonit në Egjipt.

Pastaj Musai alejhi salam izolohet nga populli i vet dhe del në Malin **Tur** për të pranuar shpalljen. Aty ndenji dyzet ditë. Vëllanë e vet Harunin e kishte lënë t'i udhëheqë ata. Kur kthehet i gjen ata duke adhuruar një viç që e patën bërë prej ari. Ky ishte nga mëkatet dhe krimet më të mëdha. Ishte kufër (mohim, mosbesim) që nuk falet. Allahu i ndëshkoi ata në atë mënyrë që ta pranojë pendimin e tyre vetëm me kushtin që të vrasin veten e tyre. Allahu i Madhëruar ka thënë në gjuhën e Musait: ***"Dhe kur Musai i tha popullit të vet: "O populli im, me adhurimin e viçit (në vend të Zotit), ju i bëtë zullum vetvetes, pra, pendohuni para Krijuesit tuaj dhe writeni veten. Kjo për ju është më e mira të Krijuesi juaj. E Ai ua pranoi pendimin tuaj, Ai është Mëshirues, ndaj e pranoni shumë pendimin."*** (Bekare 54). Sheriati për ta ka qenë i atillë që pendimi nga shirku dhe kufri të bëhet me vrasjen e vetes dhe vrasja e vetes ka qenë pranim i teubes dhe shpërblim me xhenet. Mirëpo ata edhe këtë gjë e refuzuan. Musai alejhi salam u tha: ***"Dëgjoni dhe respektoni! Ata thanë: dëgjuam dhe nuk respektojmë"***. Pas kësaj u vjen kërcënimi i Allahut dhe u kanoset me ndëshkim. U ngrihet mali **Tur** i tëri mbi kokat e tyre. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***"Përkujto kur ngritëm kodrën mbi ta si re, e ata menduan se ajo do të bjeri mbi ta. (Ne u thamë): "Merrni këtë që ua dhamë me kujdes dhe përkujtoni ç'keni në të, e të ndaleni nga ajo që është e ndaluar."*** (Araf 171), e Musai alejhi salam u tha: ***"Dëgjoni dhe respektoni! E ata thanë të nënshtruar: Dëgjuam dhe respektojmë"***.

Pastaj Musai alejhi salam zgjodhi shtatëdhjetë vetë nga më të mirët e popullit të tij për marrëveshjen që kishte me Allahun e Madhëruar te mali **Tur** për t'u arsyetuar tek Allahu për ato mëkate që bënë. Ata e panë me sytë e tyre edhe mrekullinë e njëmbëdhjetë e

ajo ishte ngritja e kodrës apo e malit Tur. Pasi dëgjuan se po u flet Allahu, ata thanë: ***“Dhe kur i thatë: “O Musa, ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim Allahun haptazi, e atëherë juve ju rrëmbeu rrufeja (zjarri) dhe ju e shihnit.”*** (Bekare 55). Allahu i vdes me Saika (rrufe të hatashme). Musai alejhi selam i thotë Allahut, se ata i ka nga më të mirët dhe Allahu i Lartësuar i ringjall për nder të tij. ***“Pastaj, që të jeni mirënjohës pas vdekjes suaj juve ju ngjallëm.”*** Bekare 56. Kjo ishte mrekullia e dymbëdhjetë. Kështu mrekullitë e Musait rrjedhën një pas një para popullit të tij, ndërsa ata vazhdonin ta shtonin kryeneçësinë dhe kufrin.

Musai alejhi selam në Palestinë

Musai alejhi selam pasi arriti me popullin e vet në portat e Palestinës iu tha se Allahu i urdhëron ata të hyjnë në shtëpinë e shenjtë (Bejtul-Makdes), e përgjigjia e tyre ishte: ***“Ata thanë: “O Musa, aty është një popull i fuqishëm, prandaj ne nuk do të hyjmë aty kurrë derisa ata të dalin andej, nëse dalin ata andej, ne do të hyjmë”.*** (Maide 22). Musai dhe Haruni alejhi selam i këshilluan që të hyjnë atje, se Allahu do t'i ndihmojë. ***“Ata thanë: “O Musa, ne kurrë nuk hyjmë atje derisa ata janë aty, shko pra, ti dhe Zoti yt e luftoni, ne po rrimë këtu!”*** (Maide 24).

Këta ishin një popull jobesimtar dhe inatçi, që nuk gjinden të tillë në të gjithë popujt e botës dhe në të gjithë historinë. Allahu iu dha atyre një ndëshkim shumë të rreptë dhe e ka bërë dënimin e tyre të vazhdueshëm deri në Ditën e Gjykimit. Pas kësaj ndodhie, Allahu iu dha gjykimit e Tij: ***“(Allahu) Tha: “Ajo (tokë) është e ndaluar për ta dyzet vjet. Do të sillen nëpër tokë (të hutuar). Ty mos të të vijë keq për popullin e shfrenuar.”*** (Maide 26). Ata humbën në atë tokë dyzet vjet dhe nuk dinin se nga është rruga për të dalë.

Rrëfimi për lopën

Gjatë periudhës së bredhjes iu ka ngjarë atyre ndodhia e lopës, për të cilën u urdhëruan ta therin. Ata parashtuan pyetje pas pyetje, këmbëngulës në inatin dhe në ngurrimin e tyre për t'i kryer urdhrat e Allahut, që iu kumtoheshin në gjuhën e pejgamberit të tyre. Mezi e therën lopën e pastaj Musai alejhi selam e mori një pjesë nga ajo lopë dhe e goditi të vdekurin për të cilin nuk dinin se kush është vrasësi. Allahu e ringjalli të vdekurin para syve të tyre, e ai tregoi emrin e vrasësit. Kjo ishte mrekullia e trembëdhjetë.

Mirëpo, a ndikoi kjo në zemrat e tyre, a i zbuti ato e t'i bëjë të ndjeshme për ibadet dhe respekt?! Ndodhi e kundërta e kësaj. Allahu i Madhëruar thotë: ***“Edhe pas (fakteve të qarta) zemrat tuaja u bënë pasandej të forta si guri, e edhe më të forta, sepse ka nga gurët prej të cilëve gufojnë lumenj, e ka disa prej tyre që çahen dhe prej tyre buron ujë, madje ka prej tyre që nga frika ndaj Zotit rrokullisen tatëpjetë*** (nga maja e kodrës). ***Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj asaj që veproni ju.”*** (Bekare 74).

Kurani ka folur rreth shumë rrëfimeve të Beni Israilëve dhe për krimet e tyre. Ata e bënë shprehi gënjeshtren, tradhtinë dhe mashtrimin, sa që u bë pjesë e moralit dhe zakoneve të tyre. E tani nuk është për t'u habitur, që ata të gënjejnë sot sërish dhe të sajojnë të gjitha mashtrimet dhe tradhtitë, gënjeshttrat dhe hipokrizitë për ta bindur botën, se ata kanë të drejtë të rrinë në tokën palestineze. ■

(vazhdon)

Marrë nga libri “Historia e Palestinës”
Përshtati Ali Shaban Tanusha